

GUIDA E SHKOLLES

PROJEKTI CLEEN



Guida e shkollës

“EDUKIMI MJEDISOR” PER CIKLIN FILLOR

©Të gjitha të drejtat: INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAJNIMIT dhe UNICEF



MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMITTE UJERAVE

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E
SHKENCES

Botimi i këtij studimi u mundësua nga UNICEF në kuadër të projektit CLEEN të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës



Ambasada e Mbretërisë së Hollandës

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. HYRJE	5
2. RËNDËSIA E EDUKIMIT MJEDISOR	6
3. PËRMBAJTJA E KURRIKULËS SË EDUKIMIT MJEDISOR DHE KOMPONENTE TË TJERË TË PROJEK TIT TË EDUKIMIT MJEDISOR CLEEN.....	7
A -Libri i mësuesit	
B –Fletorja e punës së nxënësit	
C –COMBI, si funksionon ai në kuadër të projektit CLEEN	
D-Granti shkollor për mjedisin	
4. MODELI I EDUKIMIT MJEDISOR NË SHKOLLË	12
5. FORMA TË ORGANIZIMIT TË KURRIKULËS SË EDUKIMIT MJEDISOR NË SHKOLLË .	17
6. MJEDISI DHE PROJEKTET SHKOLLORE	18
7. PËRFSHIRJA E MATERIALEVE TË LIBRIT TË MËSUESIT DHE FLETORES SË NXËNËSIT NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES	20
8. VLERËSIMI I SITUATËS MJEDISORE NË SHKOLLË DHE KOMUNITET	27
SHTOJCA 1	33
SHTOJCA 2	40
SHTOJCA 3	44

I. HYRJE

Shumëkush që merr në dorë këtë guidë mund të pyesë: “Përse shërben në të vërtetë kjo guidë e shkollës për edukimin mjedisor në ciklin fillor të shkollës 9-vjeçare?” Në të gjithë botën e zhvilluar prej vitesh po i vihet një theks i fuqishëm pajisjes së nxënësve me njohuritë dhe praktikat më të mira të mbrojtjes së mjedisit duke i parë fëmijët jo thjesht si brezin e ardhshëm me një mendësi të re dhe me shprehi të reja për mbrojtjen e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm, por edhe si ata që me fjalët dhe veprimet e tyre që në moshë të hershme mund të kenë një impakt tek prindërit, familjet e tyre dhe komunitetin që i rrethon. Shpesh është parë se para një fëmije i cili thotë që mos e lër ujin hapur së koti pasi peshqit do mbeten pa ujë, shumë prindër tërhiqen dhe fillojnë të bëhen më të arsyeshëm dhe më kursimtarë në përdorimin e ujit për nevojat shtëpiake. Shembuj të tillë ka me qindra në botë ndërkohë që këto praktika në Shqipëri kanë hyrë rishtazi.

Kjo guidë ka si qëllim që të bëjë një përmbledhje të praktikës më të mirë të edukimit mjedisor në Shqipëri, nën projektin Cleen të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave zbatuar nga UNICEF dhe mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Eksperienca e këtij projekti dhe mënyra e konceptimit të tij, përbëjnë një pikënisje të mirë për çdo projekt tjetër mjedisor për ciklin e ulët që do të vijojë në të ardhmen.

Kjo guidë i drejtohet kryesisht shkollës si një mjet orientues për përdorimin e edukimit mjedisor por edhe politikbërësve të ndryshëm të cilët në të ardhmen dëshirojnë që të përpilojnë programe dhe politika për edukimin mjedisor në Shqipëri.

Baza e edukimit mjedisor për ciklin e ulët tashmë është prezantuar dhe po përdoret në shkollën shqiptare si pjesë e orëve të lira. Kjo bazë përfshin librin e mësuesit dhe atë të nxënësit, mjetet e vlerësimit, komponentë të përfshirjes së komunitetit, etj. Për të arritur një përdorim sa më të mirë të orëve të lira për edukimin mjedisor, një trajnim intensiv është zhvilluar me mësuesit e ciklit të ulët. Ky trajnim së fundmi është vlerësuar nga Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve dhe do të çertifikohe në bazë të sistemit të krediteve.

Ne shpresojmë që kjo guidë, si një përpyetje e parë përmbledhëse, të jetë vërtetë një mjet ndihmës në duart e mësuesve, shkollës, dhe të gjithë atyre që janë të interesuar të venë në zbatim edukimin mjedisor në ciklin fillor në Shqipëri.

Guida dhe gjithë materialet e tjera shoqëruese si libri i mësuesit, fletoret e nxënësit, manuali i trajnimit etj do të përfshihen në një CD që shoqëron këtë guidë si dhe në faqen e internetit www.unicef.org. Në këtë mënyrë ne duam që të gjitha komentet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja t'i reflektojmë në këtë faqe duke e bërë këtë një dokument të gjallë dhe aktiv që i përshtatet eksperiencës dhe kohës.

II. RËNDËSIA E EDUKIMIT MJEDISOR

Çdo ditë e më shumë jemi dëshmitarë të alarmit mbarëshoqëror "Mjedisi në rrezik". Dukuri të tilla si pakësimi i sipërfaqeve pyjore, hollimi i shtresës së ozonit, ndotja e ajrit, tokës, ujit, ndryshimet klimaterike, humbja e llojeve etj. po ushtrojnë dukshëm ndikim shkatërrues mbi mjedisin.

Në këtë situatë edukimit mjedisor po i kushtohet rëndësi e madhe. Zbatimi i tij duhet bërë shpejt dhe me përgjegjësi, për të shmangur dhe zgjidhur problemet e shumta, gjithnjë e më të dukshme të mjedisit. Kjo vlen për të gjitha vendet dhe gjithë kombet. Kështu p.sh Organizata e Kombeve të Bashkuara ka shpallur se periudha 2005-2015 do të jetë Dekada e Arsimimit ku një vend të veçantë do të zërë Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Çdo ditë e më shumë edhe në vendin tonë, lëvizja mjedisore dhe edukimi mjedisor i popullatës shihen si përparësi si nga ana e sektorit shtetëror ashtu dhe atij jo qeveritar. Një vend të rëndësishëm në këtë lëvizje të gjithanshme mjedisore, zë sidomos edukimi mjedisor i nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe atyre të mesme.

Po cili është kuptimi i termit "*edukim mjedisor*"?

Termi edukimi mjedisor nënkupton procesin e njohjes dhe të qartësimit të koncepteve, zhvillimin e aftësive dhe të qëndrimeve të caktuara, për të kuptuar dhe vlerësuar ndërveprimet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, kulturës së tij dhe mjedisit rrethues bio-fizik. Edukimi mjedisor synon rritjen e përgjegjësisë individuale në marrjen e vendimeve dhe formulimin e një kodi sjelljeje për çështjet që lidhen me cilësinë e mjedisit

dhe ruajtjen e tij. Edukimi mjedisor realizohet në dy drejtime kryesore:

1. Në ndërgjegjësimin e shoqërisë se; mjedisi ndikon mbi individin dhe të gjithë individët me zgjedhjet dhe sjelljet e tyre çdo ditë ndikojnë mbi mjedisin.
2. Të kuptuarit nga gjithkush se duhet të bëjë çmos dhe të veprojë për të zvogëluar riskun e dëmtimeve që shkaktohen në mjedis nga ndjekja e politikave të caktuara të cilat, marrin në konsideratë vetëm interesat financiare duke injoruar pasojat në mjedis.

Temë qendrore për edukimin mjedisor mbetet ndërveprimi midis njeriut dhe mjedisit si dhe rritja e përgjegjësisë individuale për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Edukimi mjedisor fillon që me kontaktet tona të para me natyrën, e vazhdon më tej gjatë gjithë jetës. Edukimi mjedisor në shkollë bën ndërgjegjësimin e nxënësve për të gjitha llojet e shkatërrimeve dhe ndotjeve që po ndodhin sot në planetin tonë dhe ndaj të gjithë gjallesave të tij, ai tregon rrugët e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit dhe nxit nxënësit të sillen dhe veprojnë në këto rrugë. Ai duhet të nisë që në ciklin fillor dhe të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të nxënësve.

[Shkolla duhet t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë njohuritë e tyre mbi mjedisin, të kuptojnë mjedisin dhe të aftësohen në arsyetime e qëndrime të dobishme për sot dhe për nesër në jetën në mjedis.](#)

Ky botim synon të ndihmojë dhe identifikojë praktikën më të mira, më të suksesshme të edukimit mjedisor dhe ndikimet më afatgjata në mënyrat e të sjellurit, të vepruarit dhe të ndjerit që nxisin qytetarinë për planetin.

III. PËRMBAJTJA E KURRIKULËS SË EDUKIMIT MJEDISOR

Edukimi mjedisor është një fushë edukimi pak e pranishme në kurrikulën e ciklit fillor në Shqipëri. Në mënyrë të mëvetësishme, njohuri mjedisore janë transmetuar tek nxënësi ndërmjet lëndëve të ndryshme por ato asnjëherë nuk janë përmbledhur në një informacion të thelluar apo në formën e paketës për edukimin mjedisor. Në këtë kontekst, UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës si dhe me Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, mori përsipër një projekt trevjeçar të quajtur CLEEN. Ky projekt ka si qëllim kryesor transmetimin e njohurive për ruajtjen e mjedisit nxënësve të ciklit të ulët nëpërmjet metodologjisë ndërvepruese “Fëmija për Fëmijën” e cila lidh të mësuarin e fëmijës (në apo jashtë shkollë) me jetën e tij (në familje dhe në komunitet) në mënyrë të tillë që njohuritë të përkthehen në aksione konkrete.

Hapi i parë i ndërmarrë në kuadër të projektit ishte hartimi i një kurrikule mjedisore për ciklin fillor, e cila e sheh fëmijën si një agjent ndryshimi në mbrojtje të mjedisit në Shqipëri. Kurrikula e Edukimit Mjedisor të projektit CLEEN është e shtjelluar në detaje në dy libra bazë, libri i mësuesit dhe fletorja e nxënësit. Këto materiale janë përgatitur nga Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit në bashkëpunim me specialiste të mjedisit dhe me asistencën teknike të projektit “Fëmija për Fëmijën” në Mbretërinë e Bashkuar dhe është e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për t’u përdorur në orët e lira dhe veprimtarit kros dhe ekstrakurikulare.

Nëse i hedhim një sy më të detajuar, kurrikula përmban:

A -Libri i mësuesit

Libri i mësuesit “Edukimi mjedisor për ciklin fillor” është një guidë e përpiluar në mënyrë të atille që t’i vijë në ndihmë mësuesit për të zhvilluar hap pas hapi zhvillimin e orëve të lira për edukimin mjedisor. Kjo guidë është e ndarë në pesë module kryesore: moduli i ujit, moduli i ajrit, moduli i tokës, moduli i natyrës dhe moduli i ndotjes. Secili nga këto module përmban një mesazh kryesor për temën që mësuesi duhet të nënvizojë për atë modul dhe që nxënësi duhet të marrë me vete për ta çuar në familje apo në komunitet, informacion të përgjithshëm për temën të ndarë në disa nënçështje kryesore. Secili modul gjithashtu përmban edhe objektivat kryesore në lidhje me temën për mësuesin, për nxënësin dhe për komunitetin. Pas këtyre informacioneve vjen pjesa e aktiviteteve për secilin modul ku mësuesit i jepet orë pas orë mësimi aktiviteteve që duhet të kryejë në klasë. Këto aktivitete janë ndarë në cikle, pra aktivitete që mund të kryejë mësuesi për klasën e parë dhe të dytë, aktivitete që mund të kryhen për klasën e tretë dhe të katërt si dhe aktivitete për klasën e pestë. Për secilin cikël mësimor jepen lëndët mësimore ku mund të përdoret aktiviteti përveç orëve të lira, qëllimi dhe objektivat e tij si dhe materialet. Duke u bazuar në metodologjinë “Fëmija për Fëmijën”, mësuesit i jepen të gatshme edhe hapat që ai duhet të ndjekë për të realizuar qëllimin e cikleve, të cilat janë:

1. Të kuptuarit,
2. Zbulimi i fakteve,
3. Planifikimi dhe veprimi,
4. Diskutimi i rezultateve dhe përmirësimi.

Për secilin nga këto hapa mësuesit i jepet informacion i bollshëm dhe i hollësishëm se çfarë aktivitete duhet të kryejë me nxënësit.

Në fund të çdo moduli jepet informacion shtesë nëse mësuesi është i interesuar, si dhe një tabelë përmbledhëse e përkufizimeve dhe termave kryesore të përdorur në modul. Po ashtu në fund të modulit jepen edhe pjesë letrare që mësuesi mund t'i përdorë për të shoqëruar aktivitetet. Mësuesit duhet të bëjnë kujdes në përdorimin e terminologjisë mjedisore gjatë zhvillimit të veprimtarive, duke ia përshtatur atë moshës dhe nivelit të nxënësve. Manualet e mësimdhënies janë të organizuar në mënyrë të tillë që përputhen me vitin akademik prej 35 javësh. Jepen 5 module, secili prej të cilëve përqendrohet mbi një temë të veçantë të mjedisit si p.sh uji, ajri, toka, natyra dhe ndotja. Çdo temë ndahet më tej në 6 nën-tema, ndërsa tema e shtatë është përsëritja. Çdo nën-temë përfaqësohet nga një plan mësimor që është përgatitur duke ndjekur hapat

fëmija-fëmijës dhe mbulon 3 mësim nga 45 minuta secili. Aktivitetet e përvijuara në mësim kanë në qendër fëmijët dhe ndryshojnë nga mësimi në mësim. Disa aktivitete mund të kërkojnë më shumë kohë për përgatitje dhe zbatim se sa disa aktivitete të tjera. Moduli përdor metodologjinë " Fëmija për Fëmijen " Metoda Fëmija për Fëmijën lidh të mësuarin e fëmijëve (si brenda dhe jashtë shkollës) me jetën e tyre (në shtëpi dhe në komunitet) në mënyrë që njohuritë të transferohen në sjellje dhe veprime. Shkollat që përdorin Metodën Fëmija-Fëmijës e zbatojnë atë jo vetëm në mësimdhënie dhe të mësuar po dhe në të gjitha aspektet e jetës shkollore. Matrica Fëmija-Fëmijës tregon se si një fëmijë apo fëmijët mund të marrin pjesë në mbrojtjen e mjedisit,. Aktivitetet në grupe duhet të jenë një pjesë integrale e Metodës Fëmija-Fëmijës. Metoda Fëmija-Fëmijës lidh të mësuarin e fëmijëve (si brenda dhe jashtë shkollës) me jetën e tyre (në shtëpi dhe në komunitet) në mënyrë që njohuritë të transferohen në sjellje dhe veprime. Duke përdorur

HAPI 1: Zgjidh dhe Kupto

Fëmijët identifikojnë dhe vlerësojnë problemet e tyre shëndetësore dhe përparësitë.

HAPI 2: Zbuloj më shumë

Fëmijë bëjnë kërkime dhe zbulojnë se si këto çështje ndikojnë mbi ta dhe mbi komunitetin e tyre.

HAPI 3 : Diskuto çfarë përfundimesh nxore dhe Planin e Veprimeve që do të ndërmerresh

Bazuar mbi përfundimet e tyre, fëmijë planifikojnë veprime që ata mund të ndërmarrin mbi baza personale apo së bashku me të tjerët.

HAPI 4: Ndërmerr Veprime

Fëmijët ndërmarrin veprime me mbështetjen që ata kanë identifikuar si të nevojshme nga prindërit.

HAPI 5: Diskutimi i rezultateve

Fëmijët vlerësojnë veprimin që ndërmorën. Çfarë shkoi mirë? Çfarë paraqiti vështirësi? A kanë ndodhur ndryshime?

HAPI 6: Përmirësimi.

Bazuar mbi vlerësimin e tyre, fëmijë gjejnë mënyra për të ndërmarrë veprime të vazhdueshme dhe për t'i përmirësuar ato.

një sërë aktiviteteve ose hapa që kanë lidhje me njëri-tjetrin, fëmijët fillojnë të mendojnë mbi çështjet mjedisore, marrin vendime, zhvillojnë aftësitë për jetën dhe ndërmarrin veprime për të përkrahur një mjedis të sigurt dhe të pastër në komunitetet e tyre me mbështetjen e të rriturve.

Në librin e mësuesit hapat janë përmbledhur në :

- 1 Të kuptuarit,
- 2 Zbulimi i fakteve,
- 3 Planifikimi dhe veprimi,
- 4 Diskutimi i rezultateve dhe përmirësimi.

B – Fletoret e punës së nxënësit

Fletoret e punës së nxënësit janë pesë, një për secilën klasë të ciklit fillor. Secila fletore e një klase të caktuar përmban veprimtari që lidhen me pesë modulet kryesore të librit të mësuesit, pra uji, ajri, toka, natyra dhe ndotja. Fletorja e nxënësit ka veprimtari të thjeshta e tërheqëse që lidhen me informacionin që nxënësi ka marrë në klasë por dhe që e nxisin atë t'u drejtohet familjes dhe me gjere, komunitetit për informacion duke tejçuar në këtë mënyrë mesazhet mjedisore të marra në klasë. Veprimtaritë kanë të gjitha si qëllim kryesor ruajtjen e mjedisit dhe janë të menduara në mënyrë të tillë që të zhvillohen individualisht apo në grup fëmijësh me ose edhe pa ndihmën e mësuesit. Në fillim të çdo veprimtarie janë përcaktuar materialet të cilat mësuesi duhet t'i ketë në dispozicion si dhe me çfarë hapi është e lidhur kjo veprimtari për të lehtësuar punën e mësuesit gjatë zhvillimit të orëve të mësimit.

Aktivitet bazohen mbi katër hapat fëmija-fëmijës dhe përfshijnë: Të Kuptuarit, Zbulimin e fakteve, planifikimi dhe

veprimi dhe Diskutimi i rezultateve dhe përmirësimi.

Hapi i 'veprimit ' mund të zhvillohet ose si një aktivitet individual ose si një aktivitet që fëmija mund ta zhvillojë me familjen apo me shokët. Është gjithashtu e rëndësishme të vihet re se aktivitetet synojnë të integrojnë lëndë të ndryshme sidomos gjuhë, matematikë, art, dhe studime shoqërore.

Fletoret e punës janë përgatitur në mënyrë të tillë që të tërheqin nxënësit. Në to është përdorur një gjuhë e thjeshtë me udhëzime të thjeshta për t'u ndjekur, për të lehtësuar punën e pavarur të nxënësve. Format i është thjeshtë dhe me ngjyra të veçanta që përdoren për nivele të veçanta. Janë përdorur fotografi dhe vizatime interesante për të tërhequr fëmijët. Çdo aktivitet është formuluar që të zgjasë 15-25 minuta, në varësi të moshës së fëmijëve. Aktivitetet për klasën e parë janë të thjeshta dhe nuk kërkojnë shume kohë duke qenë se fëmijët në këtë moshë mund të përqendrohen vetëm për kohë të shkurtër. Ndërsa aktivitetet për klasën e pestë janë më të komplikuar dhe shoqërohen nga një numër detyrash që lidhen me to, si dhe integrimi i temës është shumë i dukshëm.

Si fillim mësuesi duhet të luaj rolin kryesor për t'u shpjeguar fëmijëve se si t'i përdorin fletoret e punës dhe si t'i mbajnë ato. Sidoqoftë, sapo fletoret e punës të bëhen një element i rregullt i praktikës, fëmijët do të jenë në gjendje të fillojnë lehtësisht punën më vetë. Mësuesi ka mundësi që të zhvillojë më tej aktivitete të veçanta ose të ndërmarrë hapa të mëtejshëm në varësi të interesit të treguar nga fëmijët. Nëse mësuesi ka dëshirë, ai mund të shtojë aktivitete të tjera që janë të ndërlidhura me tema të tjera në fletoren e punës, si p.sh të zhvillojë më tej një tregim që fëmijët e kanë lexuar në orën e gjuhës [letërsisë] dhe ta lidhë atë me temat e mjedisit. Në

të njëjtën mënyrë, aktivitetet matematike të tilla si grafikët standardë apo grafikët e rrumbullakët mund të integrohen me një nga aktivitetet në fletoren e punës.

Është e rëndësishme të mbajmë mend që t'i bëjmë fëmijët të ndihen mirë kur përdorin fletoren e punës dhe ta bëjmë të mësuarin e tyre të këndshëm!

C – COMBI, si funksionon ai në kuadër të projektit CLEEN

Programe tradicionale dhe promocionale mbi "Informimin, Arsimimin, Komunikimin" (IAK) kanë bërë të mundur të rrisin sensibilizimin dhe dijet por nuk kanë qenë aq të suksesshëm sa për të arritur rezultate mbi sjelljen. Është e qarte se njerëzit e informuar dhe të edukuar, megjithëse kritike, nuk kanë baza të mjaftueshme për të sjellë ndryshime në sjellje. Është tjetër gjë të dish dhe tjetër të bësh. Rritja e ndërgjegjësimit dhe dijeve janë të rëndësishme, por fatkeqësisht ato janë të pamjaftueshme për të pasur rezultate mbi sjelljen. Impakti i sjelljes do të arrihet vetëm me programe efektive mbi komunikimin, të ndërtuara qëllimisht për sjelljet, dhe jo të ndërtuara thjesht si një çështje mbi sensibilizimin, ose informimin apo edukimin publik.

Komunikimi për Impaktin tek Sjelljet (ne ang. COMBI), bazuar në metodën e sektorit privat të Komunikimit të Integruar të Marketingut (ne ang. IAK), ofron një metodë dinamike për të arritur rezultate mbi sjelljen në zhvillimin social.

Sektori privat për mëse 100 vjet po përdor suksesshëm komunikimin e marketingut me sjelljen konsumatore (qoftë për produkte të pakëndshme, qoftë për ato të shkëlqyerat) gjë që shpie drejt një metode të aplikueshme (me modifikimet e duhura) për zhvillimin social. IMC dhe adaptimi i saj COMBI

brenda programeve të agjencive ndërkombëtare si p.sh UNICEF-it, fillojnë me klientin/konsumatorin dhe me një fokusim të mprehtë mbi rezultatet e pritshme të sjelljes të ndërtuara qartë nga kërkime praktike të tregut dhe një analizë të situatës së tregut lidhur me sjelljen e dëshiruar. Ka nevojë për një zbatim të integruar të disiplinave të edukimit për të rritur, komunikimin masiv, mobilizimin e komunitetit, mediet, marketingun (përfshirë edhe traditat e marketingut në nivel fshati), reklamimin, marrëdhëniet publike dhe avokatinë publike, këshillimin, shitjen personale, marrëdhëniet me klientë/konsumatorë dhe studimin e tregut për të arritur qëllimin përfundimtar që të sigurohen rezultatet e mira të sjelljes.

Puna e UNICEF-it dhe e partnerëve të tij në Projektin CLEEN mbulon një gamë të gjerë të ndryshimeve të sjelljeve. Projekti sugjeron rezultate shumë specifike të sjelljes si qëllimin përfundimtar të dëshiruar. Rezultatet e sjelljes së synuar do të sigurohen vetëm nëpërmjet komunikimit efikas publik dhe personal që kapërcen barrierat të cilët frenojnë pranimin e sjelljeve të rekomanduara. Së paku, përpjekjet për komunikim në këtë fushë duhet të bëjnë më shumë sesa vetëm të botojnë postera dhe pamflete të nxjerra nxitimthi të cilat shpesh dominojnë fushën e zhvillimit të komunikimit në sektorin social në shumë vende.

COMBI brenda projektit CLEEN

Projekti CLEEN është i bazuar në parimin se nuk është e mjaftueshme vetëm t'i mësosh fëmijëve ruajtjen e mjedisit por duhet gjithashtu që të nxisësh veprimin dhe aksionin civil të tyre për të ndryshuar sjelljet dhe për të vënë në zbatim atë që ta kanë mësuar në tekstet shkollore. Pikërisht për këtë qëllim, në këtë projekt është parashikuar

një aktivitet masiv komunikimi për ndryshimin e sjelljeve i quajtur "Unë e dua Shqipërinë time të bukur e të pastër". Sjellja kryesore që është synuar nga ky projekt është ajo e mbajtjes pastër se ambienteve dhe moshedhjes së mbeturinave kudo, sidomos të atyre plastike si qese e shishe.

mësimdhënies së edukimit mjedisor të trajnuar nga projekti CLEEN. Aktivitetet e tij do të shtrihen në rreth 40 shkolla dhe 450 klasa dhe do të sigurojnë që 13,500 nxënës nga këto klasa të mbledhin së bashku me anëtarët e tjerë të komunitetit (p.sh. një anëtar familjes) mbeturina plastike.

Tabela 1. Shpërndarja e shkollave pjesëmarrëse në aktivitetet e COMBI-t që do të jenë si më poshtë:

Rrethi	Nr. Shkollave në projekt		Nr. i klasave për çdo shkollë fillore (1-5)		Nr. i nxënësve për klasë		Nr. i nxënësve për shkollë	
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat
Tiranë	8	4	15	5	30	30	3.600	600
Shkodër	5	3	15	5	30	30	2.250	450
Durrës	7	3	15	5	30	30	3.150	450
Korçë	3	2	15	5	30	30	1.350	300
Lezhë	4	1	15	5	30	30	1.800	150
Sub totali	27	13	390	60			12.150	1950
Total	40 shkolla		450 klasa				13.500	

Aktivitetet e COMBI-t janë menduar të zgjasin 18 muaj dhe do të ketë disa fusha kryesore ndërmjet të cilave mund të veçojmë:

- Zbatimi i një programi aktivitetesh promovuese në media në mënyrë që të vendosen në qendër të vëmendjes së agjendës publike çështje të ndryshme që lidhen me moton "Shqipëria ime e bukur dhe e pastër".
- Zbatimi i një programi mobilizimi të komunitetit për shkollat fillore për të promovuar sjellje pozitive ndaj mbledhjes së mbeturinave.
- Hartimi i një plani promovimi i cili lidh shkollën me institucionet qeveritare dhe komunitetin në të mirën e ruajtjes së mjedisit.

COMBI nuk do të zhvillohet në të gjitha shkollat ku do të ketë aktivitet të

Aktivitetet e tjera të COMBI-t si ajo e fushatës sensibilizuese për të vendosur në qendër të vëmendjes së agjendës publike çështje të "Shqipëria ime e bukur dhe e pastër" si spotet në TV, radio, gazeta, etj., do të kenë një shtrirje kombëtare dhe do mbulojnë të gjithë fëmijët e moshës së shkollës fillore.

Ky plan do të zhvillojë gjithashtu edhe një sërë aktivitetesh për mobilizime administrative si konsultime dhe mbledhje në shkallë të gjerë, firmosje memorandumesh me qeverinë, konferenca kombëtare, etj.

D - Granti shkollor

Një tjetër komponent i projektit Cleen do të jetë edhe granti shkollor. Granti shkollor është i menduar në formën e një granti të vogël që do të shërbejë për të konkretizuar aksionet e shkollave në kuadrin e edukimit mjedisor. Shkollave

pjesëmarrëse në projekt do t'u kërkohej që të konkurrojnë në bazë të kriterëve të paracaktuara për të përfituar grantet e vogla. Ky aktivitet është një aktivitet komplementar i kurrikulës së edukimit mjedisor ku disa nga aktivitetet e menduara në libër mund të bëhen realitet në kushtet e mungesave financiare në të cilat has sot shkolla.

IV. MODELI I EDUKIMIT MJEDISOR NË SHKOLLË

Synimet kryesore për edukimin mjedisor në shkollë 9-vjeçare janë:

1. Të nxitë nxënësit të studiojnë e interpretojnë mjedisin në këndvështrimet fizik, gjeografik, biologjik, sociologjik, ekonomik, politik, teknologjik, historik, estetik, etik, shpirtëror etj;
2. Të sigurojë për të gjithë nxënësit shanse për të fituar njohuri, kuptime, vlera dhe qëndrime të nevojshme për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin;
3. Të krijojë modele të reja të sjelljes së individëve ndaj mjedisit, për të mos e prekur atë dhe për të marrë pjesë aktive me vendime mbi problemet e mjedisit, në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Që këtë rrjedhin disa objektiva të përgjithshme të edukimit mjedisor, ku nxënësit duhet:

- të njohin faktorët e ndryshëm që ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në mjedis;
- të kuptojnë se njeriu ndikon gjerësisht mbi mjedisin në shkallë lokale, kombëtare dhe më tej;
- të jenë të përgatitur për të

analizuar informacionin mjedisor duke mbajtur qëndrim kritik ndaj tij;

- të aftësohen për të përshkruar një sistem mjedisor dhe të vlerësojnë ndërveprimet ndërmjet sistemeve;
- të aftësohen për të nxjerrë konkluzione nga vëzhgimet individuale apo analizat e materialeve të ndryshme burimore, për të gjetur zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e mjedisit;
- të aftësohen për të punuar në grupe pune për të zhvilluar një veprimtari të dobishme mjedisore;
- të zhvillojnë ndjeshmërinë për problemet e mjedisit human dhe natyror dhe aftësinë për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen problemeve komplekse mjedisore.

Synimet dhe objektivat e edukimit mjedisor realizohen përmes veprimtarive mësimore të edukimit mjedisor, të cilat grupohen në disa elemente bazë, të përcaktuara si pjesë përbërëse të rëndësishme të këtij edukimi. Përshkrimi i elementeve bazë, që bëjnë pjesë në realizimin e edukimit mjedisor bëhet në vijim:

- Elementi empirik, kërkon që kurrikula e edukimit mjedisor t'u mundësojë nxënësve kontaktin e drejtpërdrejtë me mjedisin përmes vëzhgimit, matjes, mbajtjes së shënimeve, interpretimit dhe diskutimit e dukurive të vëzhguara. Veprimtari të tilla mësimore të edukimit mjedisor zhvillojnë tek nxënësit aftësitë e vëzhgimit, matjes dhe analizës së dukurive të natyrës.

- **Elementi sinoptik**, kërkon që nxënësit në edukimin mjedisor të realizojnë studimin e çështjeve mjedisore në kompleksitet. Kështu përmes edukimit mjedisor nxënësit duhet të kuptojnë lidhjen e pandashme midis përbërësve të ndryshëm të një mjedisi, ndërveprimin dhe ndikimin e ndërsjellë të tyre. Ata gjithashtu duhet të ndërthurin çështjet e ndryshme mjedisore me ndikimin mbi to të faktorëve të shumtë socialë, ekonomikë etj.
- **Elementi estetik**, është e rëndësishme që nxënësit të pëlqejnë dhe ndjehen mirë në mjedisin e tyre. Edukimi mjedisor nuk mund të përcjellë sjellje dhe qëndrime pozitive ndaj mjedisit pa mundësuar më parë ndjeshmërinë dhe dashurinë për mjedisin. Edukimi mjedisor është e rëndësishme që ta përcjellë këtë ndjesi por sugjerohet, që nxënësit të ndihmohen për të kuptuar se çështjet estetike nuk kanë përgjigje absolute të njëjtë për të gjithë.
- **Elementi etik**, ka lidhje të ngushtë me vetë qëllimet e edukimit mjedisor të cilat, përmbajnë idenë e formimit tek nxënësit të ndjenjës së përgjegjësisë personale mbi mjedisin dhe përpjekjet për ruajtjen e tij. Sugjerohet që veprimet e nxënësve të ballafaqohen me moralin e së mirës, të dobishmes, të së drejtës etj. Në ndërmarrje të tilla konsiderohen dhe stimulohen vlerat morale të nxënësve.

Vëmendje kërkohet dhe për shtjellimin e konceptit "Cilësi mjedisi". Nën këtë term duhet nënkuptuar që cilësia e mjedisit është një ndër përbërësit e cilësisë së jetës, dhe se këtij koncepti i korrespondojnë një sërë faktorësh

biologjikë dhe jo biologjikë, që ndikojnë në jetën e njeriut dhe në të njëjtën kohë janë të ndikuara prej veprimtarisë së tij. Në edukimin mjedisor duhet bërë shumë kujdes që nxënësit të kuptojnë ndërvarësinë midis gjithë faktorëve që ndikojnë në cilësinë e mjedisit në shkallë globale.

Elementet bazë të mësipërm, bëhen realitet në një larmi veprimtarish mësimore, që orientohen në tre plane kryesore të të mësuarit në edukimin mjedisor:

1. Të mësuarit rreth mjedisit që nënkupton informacion, njohuri, aftësi që do t'u duhen nxënësve nëse hedhin vështrimin në çështjet e mjedisit. Këtu bën pjesë p.sh të mësuarit rreth përbërësve të atmosferës; burimeve të ndotjes së ajrit, ujit, urbanizimit, mbetjeve, sipërfaqeve të gjelbra dhe biodiversitetit, ndotjes nga zhurmat, riciklimit dhe ripërdorimit, ndryshimeve klimaterike, burimet e energjisë, pyjet etj.

Nëse do t'i referohemi librit të mësuesit përgatitur nga UNICEF-i në vitin 2008, dhe pikërisht veprimtarive të hapit të parë në të "Të kuptuarit" (sipas metodologjisë "Fëmija për Fëmijën"), do të arsyetonim se pikërisht në procesin mësimor që i takon këtij hapi, mundësohet të mësuarit rreth mjedisit.

2. Të mësuarit në mjedis që nënkupton mjedisin si burim informacioni. Mjedisit përdoret si burim në dy mënyra: (i) e para, mjedisit siguron burime materiale për veprimtari jetësore në këndvështrimet gjeografike, shkencore, matematikore, etj.; dhe (ii) e dyta, mjedisit shfrytëzohet me sukses si vend për veprimtari kërkuese, hulumtuese të nxënësve duke ndikuar në drejtim të mënyrës së të mësuarit dhe të cilësisë së të mësuarit.

Nëse do t'i referohemi librit të mësuesit

përgatitur nga UNICEF-i ne vitin 2008, dhe pikërisht veprimtarive të hapit të dytë në të "Zbulimi i fakteve" (sipas metodologjisë "Fëmija për Fëmijën"), do të arsyetonim se pikërisht në procesin mësimor që i takon këtij hapi, mundësohet të mësuarit në mjedis.

3. Të mësuarit për mjedisin, nënkupton vendosjen e theksit në formimin e individit aktiv ndaj problemeve të mjedisit, krijimin e sjelljeve dhe qëndrimeve efektive dobiprurëse të nxënësve për mjedisin. Edukimi mjedisor duhet të zhvillojë njohuritë e nxënësve sidomos për problemet e ditës dhe t'i japë përparësi aftësimin të tyre për të analizuar problemet dhe për të gjetur zgjidhjet optimale mbi shqetësimet e mëdha që janë shfaqur sot për mjedisin dhe për perspektivën mjedisore.

Duke tërhequr vëmendjen e nxënësve se për problemet mjedisore duhet të mendohet globalisht dhe të veprohet lokalisht, mundësohet nxitja e nxënësit për të menduar dhe vepruar për problemet mjedisore të zonës.

Edukimi mjedisor lidhet me një sërë veprimtarish praktike që konkretizojnë përmbajtjet mësimore, veprimtari këto të parashikuara në të mësuarit të tilla si investigimet për ndotjen e ujit të pijshëm, për ndikimin e ndotjeve mbi bimësinë etj. Në qoftë se për shembull në mësim, shqyrtohet ndikimi i plehrave kimike në ndotjen e ujit, dhe në mënyrë konkrete zhvillohen aktivitete praktike që e vërtetojnë këtë fakt, këto shihen si aktivitete mësimore të vlefshme për të mësuarin. Kurse nëse veprimtaria që kryejnë nxënësit lidhet me shmangien apo pengimin e kësaj dukurie të dëmshme mjedisore, dhe në sajë të së cilës problemi mjedisor gjen zgjidhje, kjo i përket termit veprim mjedisor. Veprimi shihet si tjetër element mjaft i rëndësishëm, ku personi vendos të bëjë diçka sipas mendjes së tij.

Përfshirja e nxënësve në aktivitete të drejtuara kah zgjidhjes së problemit, dhe të vendosura nga vetë ata, shihet si një çështje që përgatit nxënësit me aftësi veprimi mjedisor. Nxitja tek nxënësit e "kompetencës së veprimit për mjedisin" është detyrë e rëndësishme e edukimit mjedisor. Dhe kjo do të thotë, që të mësuarit në edukimin mjedisor krahas të mësuarit për sjellje dhe stile të orientuara jetësore në dobi të ruajtjes dhe mbrojtjes të mjedisit, duhet t'i aftësojë nxënësit për veprimtari në drejtim të zgjidhjes të problemeve mjedisore. Termi "kompetencë e veprimit për mjedisin" shihet i lidhur me një sërë elementesh të nevojshëm si: Njohuritë, zotimet, vizionet, shprehjet e veprimit. Parë në këtë plan edukimi mjedisor synon të sjellë më parë nxënësit drejt një të kuptuari të çështjeve të cili, pastaj i ndihmon ata të vlerësojnë ndërmarrjen e sjelljeve dhe aksioneve nën termin e qëndrueshmërisë.

Nëse do t'i referohemi librit të mësuesit përgatitur nga UNICEF-i, dhe pikërisht veprimtarive të hapit të tretë në të "Planifikimi dhe veprimi" (sipas metodologjisë "Fëmija për Fëmijën"), do të arsyetonim se pikërisht në procesin mësimor që i takon këtij hapi, mundësohet të mësuarit për mjedisin. Përmes veprimtarive të këtij hapi zhvillohen veprimtari që drejtojnë nxënësit në sjellje pozitive ndaj mjedisit ashtu dhe në aksione për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (kompetenca e veprimit mjedisor).

Edukimi mjedisor ka gjithashtu një element të rëndësishëm që është ndërgjegjësimin e nxënësve për gjendjen aktuale të mjedisit në komunitet dhe më tej në botë dhe stimulimin e nxënësve për të punuar së bashku me familjet, mësuesit, komunitetin e afërt dhe më tej. Nëse do t'i referohemi librit të mësuesit përgatitur nga UNICEF-i, dhe pikërisht veprimtarive

të hapit të tretë në të “Planifikimi dhe veprimi” (sipas metodologjisë “Fëmija për Fëmijën”), do të gjejmë se pikërisht në procesin mësimor që i takon këtij hapi, mundësohen një sërë veprimesh të nxënësve së bashku me familjet, mësuesit, komunitetin. Këto veprimtari duhen vlerësuar dhe realizuar me kujdes nga mësuesit e ciklit fillor që zbatojnë këtë manual.

Metodologjia e edukimit mjedisor

Përgjithësisht është pranuar se pedagogjia tradicionale, e cila e trajton nxënësin si marrës pasiv të informacionit, njohurive dhe fakteve nuk është e mjaftueshme për të ndryshuar mënyrat e të sjelljes dhe të menduarit në përgjithësi dhe edukimin mjedisor në veçanti. Praktika mësimore në edukimin mjedisor ka treguar se nxënësit janë shumë më të kënaqur dhe të interesuar ndaj të mësuarit konkret dhe praktik, në situata të vërteta jetësore. Përfshirja në mësim e aktiviteteve që bazohen në nxitjen e ndjenjave siç janë përfytyrimet e udhëzuara, dramatizimet, loja me role, meditimet, shpłodhjet në natyrë janë shumë efektive në edukimin mjedisor të nxënësve në shkollën fillore. Ekskursionet në natyrë nxitin kontaktet me natyrën, dhe dashurinë për të. Tregimi i historive në veçanti për kafshët është shumë efektiv për nxitjen e një mënyre qytetare të mbrojtjes së mjedisit.

Edukimi mjedisor me synim ndryshimin e sjelljeve të nxënësve në drejtim të parashikuar e të paramenduar, kërkon përpjekje drejt strategjive efektive të tilla si përgatitje e posterave, fletë-palosjeve, eseve, krijimeve në pikturë etj me temë nga mjedisi. Përfshirja e nxënësve në veprimtari të drejtuara në zgjidhjen e problemeve, të vendosura nga vetë ata, si tubimet, letrat drejtuar drejtuesve lokalë, aksionet për përmirësimin e

mjedisit etj. janë metoda që nxisin pajisjen e nxënësve me kompetencën e veprimit mjedisor.

Mësuesi/ja mund të përzgjedhë ato metoda apo teknika të cilat nxisin diskutimin, debatin, refleksionin apo vlerësimin e situatave dhe në përshtatje me moshën e nxënësve. Në tërësinë e metodave dhe teknikave përmendim disa prej tyre, të tilla si situatat e rastit, loja në role, demonstrimi, fotot, posterat, kolazhet, tregimet, historitë, etj., për të vetmen arsye se përdorimi i tyre përmbush më së miri pritshmërinë e mësuesve për trajtimin e problematikave të ndryshme mjedisore. Kjo nuk e privon aspak mësuesin/en nga liria për të përdorur metodën, teknikën apo për të hartuar strategjinë që ai/ajo e konsideron si më efektive në kushtet konkrete të klasës që ai/ajo punon

Fëmija për Fëmijën

“Fëmija për Fëmijën” është një rrjet ndërkombëtar që përkrah pjesëmarrjen e fëmijëve në mbrojtjen e mjedisit, në shëndet dhe zhvillim. Qendra e tij ndodhet në Universitetin e Londrës, në Mbretërinë e Bashkuar. Ai zhvillon aktivitetin e tij në mbi 70 vende, duke u ardhur në ndihmë përafërsisht 1.5 milionë fëmijëve në vit.

Metodologjia Fëmija për Fëmijën është një proces edukues që lidh të mësuarin e fëmijëve me ndërmarrjen e veprimeve për të përkrahur mirëqenien dhe zhvillim e tyre, të familjeve të tyre, komunitetit ku jetojnë, duke përfshirë dhe mjedisin. Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara rritet zhvillimi personal, fizik, shoqëror, emocional, moral dhe intelektual i fëmijëve. Kjo metodë ka disa synime kryesore:

- Respekton këndvështrimet dhe zërat e fëmijëve në mënyrë që t’u krijojë atyre mundësinë

për t'u zhvilluar në të rritur të përgjegjshëm;

- Mbështet pjesëmarrjen aktive të fëmijëve që lidh të mësuarin me jetesën dhe nxit reflektimin;
- Lehtëson të kuptuarin nga ana e fëmijëve të çështjeve të mjedisit, shëndetit dhe zhvillimit, dhe pse janë të rëndësishme sjelljet pro-mjedisore dhe sjelljet e shëndetshme;
- Përfshin aktivitete argëtuese të përshtatshme dhe të realizueshme, të cilat nxisin aftësitë për jetën, besimin në vetvete dhe respektin për veten;
- Zhvillon aftësitë vendim-marrëse dhe problem-zgjidhëse të fëmijëve, në mënyrë që ata të ndër marrin veprime në lidhje me përparësitë e identifikuar.
- Zhvillon aftësitë e fëmijëve për të komunikuar, për të qenë të

ndjeshëm dhe për të përballuar situatat e vështira.

- Njeh aftësitë e fëmijëve si agjentë të ndryshimit, të cilët kanë nevojë për mbështetje lehtësuese por jo për mbizotërimin e të rriturve.
- Siguron që zhvillimi personal i fëmijës që zhvillon aktivitetet është po aq i rëndësishëm sa dhe i fëmijës me të cilin ai po punon (p.sh fëmijët më të rritur që punojnë me fëmijët parashkollorë).

Metoda Fëmija për Fëmijën lidh të mësuarin e fëmijëve (si brenda dhe jashtë shkollës) me jetën e tyre (në shtëpi dhe në komunitet) në mënyrë që njohuritë të transferohen në sjellje dhe veprime. Shkollat që do të përdorin këtë metodologji e zbatojnë atë jo vetëm në mësimdhënie dhe të mësuar, por edhe në të gjitha aspektet e jetës shkollore. Aktivitetet në grupe duhet të jenë një pjesë integrale e saj. Duke përdorur

Skema 1. Metoda hap pas hapi

HAPI 1: Zgjidh dhe Kupto

Fëmijët identifikojnë dhe vlerësojnë problemet e tyre shëndetësore dhe përparësitë.

HAPI 2: Zbuloj më shumë

Fëmijë bëjnë kërkime dhe zbulojnë se si këto çështje ndikojnë mbi ta dhe mbi komunitetin e tyre.

HAPI 3 : Diskuto çfarë përfundimesh nxore dhe Planin e Veprimeve që do të ndërmarrësh

Bazuar mbi përfundimet e tyre, fëmijë planifikojnë veprime që ata mund të ndërmarrin mbi baza personale apo së bashku me të tjerët.

HAPI 4: Ndërmerr Veprime

Fëmijët ndërmarrin veprime me mbështetjen që ata kanë identifikuar si të nevojshme nga prindërit.

HAPI 5: Vlerëso

Fëmijët vlerësojnë veprimin që ndërmorën. Çfarë shkoi mirë? Çfarë paraqiti vështirësi? A kanë ndodhur ndryshime?

HAPI 6: Bëje më mirë

Bazuar mbi vlerësimin e tyre, fëmijë gjejnë mënyra për të ndërmarrë veprime të vazhdueshme dhe për t'i përmirësuar ato.

një sërë aktiviteteve ose hapa që kanë lidhje me njëri-tjetrin, fëmijët fillojnë të mendojnë mbi çështjet mjedisore, marrin vendime, zhvillojnë aftësitë për jetën dhe ndërmarrin veprime për të përkrahur një mjedis të sigurt dhe të pastër në komunitetet e tyre me mbështetjen e të rriturve. Hapat që ndjek kjo metodologji janë 6 por mund të kryhen edhe në katër (Skema 1).

V. FORMA TË ORGANIZIMIT TË KURRIKULËS SË EDUKIMIT MJEDISOR NË SHKOLLË

Praktika e sotme ndërkombëtare për realizimin e edukimit mjedisor në shkollë njih si formë më të përhapur të organizimit të kurrikulës për këtë edukim, formën kroskurrikulare, veprimtaritë ekstrakurrikulare dhe më pak të përhapur realizimin e edukimit mjedisor si një lëndë më vete, me zgjedhje ose e detyruar.

A. Forma kroskurrikulare

Forma kroskurrikulare nënkupton që edukimi mjedisor i nxënësve të realizohet përmes të gjitha lëndëve shkollore, apo të një grupi lëndësh me të cilat, edukimi mjedisor ka lidhje më të ngushtë.

Tre janë modelet kroskurrikulare, që mund të zbatohen.

Model 1: Kroskurrikular në bazë klase ose ndryshe integrimi në kurrikulat lëndore. Bazohet në trajtimin e

veprimtarive të parashikuara, si material plotësues për tema të caktuara mësimore, në të gjitha lëndët mësimore ose një grup lëndësh që nxënësit e një klase studiojnë. Nisur nga fakti që studimi i mjedisit lidhet me disa lëndë, kërkohet nga të gjithë mësuesit që bashkë me bërjen e planit vjetor lëndor për një klasë të caktuar të shënojnë me një simbol të dhënë, p.sh një yll, një rreth etj., ato tema mësimore në të cilat studiohen ose ka mundësi të përfshihen në mënyrë të natyrshme çështjet mjedisore, duke bërë të mundur që planifikimi i edukimit mjedisor si kroskurrikul në bazë klase të mos i lihet spontanitetit

Trajtimi i çështjeve mjedisore në tema të caktuara të lëndëve të ndryshme mësimore duhet të bëhet në mënyrë të natyrshme, në mënyrë që çështja e dhënë të mos jetë një hallkë shtesë në procesin mësimor të një lënde të caktuar. Kështu nëse do t'i referohemi librit të mësuesit përgatitur nga UNICEF, mësuesi në lëndën e diturisë së natyrës do të planifikojë veprimtari të këtij manuali për ujin, ajrin pikërisht në temat që përmban lënda e diturisë për ujin, ajrin. Po kështu veprohet dhe për të gjitha lëndët e tjera.

Model 2: Kroskurrikul me anë veprimtarish, emërtuar ndryshe si veprimtari ekstra-kurrikulare. Nënkupton planifikim të veprimtarive në bazë shkolle, klase, të iniciuara nga tematika e mjedisit, në përputhje me kushtet e klasës, shkollës. Në këtë model e gjithë shkolla në një ditë dhe orë të caktuar merr pjesë në një veprimtari për mjedisin, e cila mund të jetë një aksion për mbjellje pemësh, një takim me një specialist të pyjeve apo të një fushe tjetër mjedisore, shikim i një filmi apo ekspozite për mjedisin etj.

Veprimtari që i përkasin këtij modeli janë të shumta dhe të dobishme por ato nuk mund të vetme të realizojnë objektivat

e edukimit mjedisor në shkollë, ato duhet të plotësojnë edukimin mjedisor që realizon shkolla sipas modelit kroskurrikular në bazë klase apo sipas modelit si lëndë me vete.

Model 3: Kroskurrikular në bazë shkolle, e cila bazohet në të mësuarit me anë të projektit. Shkolla ndërmer një projekt për një problem mjedisor shqetësues në shkollë dhe/ose komunitet. Për realizimin e projektit punon një masë e madhe nxënësish nga klasa të ndryshme brenda orëve të mësimit dhe jashtë tyre, në një periudhë kohore nga disa javë deri në një vit apo më shumë. Përmes projekteve mjedisore nxënësit rrisin shkallën e ndërgjegjësimit ndaj mjedisit, e studiojnë mjedisin në formë të integruar dhe formohen si veprimtarë aktivë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes projekteve mjedisore mundësohet integrimi i të gjithë mësuesve dhe i të gjitha lëndëve në trajtimin e një problemi të caktuar mjedisor, çka nënkupton trajtim të problemit mjedisor në të gjitha pikëpamjet e nevojshme. Mendimi se, ç'mund të bëjnë nxënësit për zgjidhjen e një problemi mjedisor, por një koncept i tillë është i gabuar, sepse një projekt mjedisor i shkollës për mjedisin nuk nënkupton zgjidhje të mëdha e të pamundura për nxënësit, ai nënkupton hapa të vegjël të cilët, janë të dobishëm si për mjedisin ashtu dhe për edukimin mjedisor të nxënësve (Shiko Shtojcën 3).

B. Edukimit mjedisor si lëndë më vete

Trajtimi i edukimit mjedisor si lëndë me vete është një formë tjetër e mundshme e realizimit të edukimit mjedisor në shkollë. Kjo nënkupton që edukimi mjedisor të trajtohet si çdo lëndë tjetër në shkollë, në një orar të caktuar javor dhe nga një mësues i vetëm.

Në lidhje me format e organizimit të kurrikulës së edukimit mjedisor në shkollë, është e qartë se ka anë të pozitive dhe ato negative për secilën prej formave të mundshme në të cilat ky edukim zhvillohet në shkollë, prandaj lihet në dorë të Ministrisë përkatëse, Drejtorive Arsimore dhe vetë shkollave të përzgjedhin formën më të përshtatshme.

VI. MJEDISI DHE PROJEKTET SHKOLLORE

Shkolla duhet të kthehet në një mjedis me një ndjenjë të madhe komuniteti dhe përkatësie për gjithçka që ndodh dhe duhet të ndodhë atje, madje jo vetëm në fushën e mjedisit por edhe në fusha të tjera të jetës shoqërore. Çdo shkollë ka një marrëdhënie të caktuar me mjedisin jashtë saj, në varësi të vendit ku ajo ndodhet: në qytet ose fshat, në qendër apo në periferi etj. Shkollat mund të përfshihet në projekte studimore të ndryshme, në varësi të mjedisve pranë saj, si për shembull:

- Një shkollë që është pranë një liqeni mund të ofrojë mundësi për të njohur me gjallesat që jetojnë pranë ujit ose në të, duke i përdorur këto si tregues të shëndetit të këtij ambienti;
- Një shkollë që ndodhet pranë një pylli jep mundësinë për të dalluar pemët dhe bimët kryesore ose të veçanta të tij. Ato mund të studiojnë ndryshimet pozitive ose negative që kanë ndodhur në zonën e tyre si dhe faktorët që kanë shkaktuar këto ndryshime

(pasoja negative që mund të jenë shkakuar nga prerjet e shumta në klimë, tokë ose në aspekte të ndryshme të jetës së gjallesave).

Gjatë përfshirjes në projekte, nxënësit veprojnë së bashku. Kjo i bën atë të mësojnë vlerat e punës në grup dhe forcën e grupit për ndryshimet pozitive në dobi të mjedisit.

Mësuesit i planifikojnë veprimtaritë e tyre së bashku me nxënësit që u jep atyre edhe një ndjenjë të fortë të përkatësisë së asaj çfarë bëjnë. Megjithatë këto projekte zhvillohen së bashku edhe si veprimtari jashtëkurrikulare, ato mund të integrohen në hapësirat e mundshme që krijohen në lëndë ose në tema të ndryshme. Duke i lidhur lëndët së bashku rreth një teme, procesi i të nxënësve pasurohet me përmasa të reja të shikimit global të realitetit dhe të mjedisit në mënyrë të veçantë, gjë që ka ndikim afatgjatë të nxënësit dhe tek të nxënësit e tyre gjatë gjithë jetës.

Projektet e kujdestarisë

Këto projekte mund të përfshijnë patronazhin për nxënësit e klasave më të ulëta nga ata më të larta në shkollën e tyre ose në shkollën tjetër, që ndodhen në afërsi të saj, ose kujdestarinë për zona të caktuara që ndodhen në mjedisin përreth ose pranë shkollës. Projektet e kujdestarisë ose të patronazhit, përfundojnë pas një kohe të caktuar 4-8 javë me një paraqitje zbavitëse të rezultateve që ndahen me të gjithë shkollën ose me një grup shkollash fqinje. Në këtë paraqitje mund të përgatiten edhe pjesë zbavitëse me muzikë, lojë me role etj. Duke marrë pjesë në këto projekte nxënësit mësojnë për mjedisin duke punuar vetë aktivisht në të. Kjo jo vetëm është më motivuese për ta, por rrit lidhjet e tyre me shkollën,

grupe, individë të tjerë, me të cilët fillon të ndajnë të njëjtat shqetësime dhe angazhime për mbrojtjen e mjedisit.

Partneriteti

Mjaft përvoja të fëmijëve mbeten thjesht kujtime të izoluara të shkollës së tyre fillore dhe të palidhura me jetën e tyre të mëvonshme ose me ata që ata do të mësojnë më vonë në shkollë. Duke krijuar një marrëdhënie partneriteti ata mund të ndihmohen të lidhin përvojën e tyre paraprake me shkollën dhe bashkësinë. Kjo do t'i jepte kuptim përvojës së tyre dhe do ta lidhte me angazhimin e tyre të përgjegjshëm për mbrojtjen e mjedisit.

Për arsye të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare është e nevojshme vendosja e lidhjeve më të ngushta të shkollës me komunitetin dhe me prindërit. Vetëm në këtë mënyrë, përvoja e nxënësve në shkollë mund të marrë vlerë praktike e të kalojë në mjediset jashtë saj, në shtëpi, në lagje etj. Nxitja e projekteve në bashkëveprim me aktorë të ndryshëm në komunitet do të rriste pamasë mundësitë e procesit të të nxënësve dhe të prodhimit të ndryshimeve praktike në dobi të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

Përfitimet e drejtpërdrejta të këtyre projekteve janë ato që lidhen me:

- edukimin e ndjenjës së kujdestarisë për mjedisin;
- fitimin ose konsolidimin e njohurive bazë për konceptet bazë që lidhen me kuptimin dhe ruajtjen e mjedisit;
- kuptimin e ndërvlerësisë së komuniteteve natyrore dhe kulturore dhe ndikimin e njeriut në mjedis;

- përfitimet që sjell puna e përbashkët.

Puna e shkollës me komunitetin kërkon edhe planifikim të kujdesshëm të veprimtarive që ngrihen mbi bazën e identifikimit dhe njohjes së mirë të burimeve të ndryshme njerëzore dhe financiare në komunitet.

Shembuj projektesh

Projektet që mund të zhvillohen në fushën e edukimit mjedisor, në kuadrin e bashkëpunimit dhe të partneritetit shkollë-komunitet në nivel vendor mund të jenë prodhimi i kalendarëve me tema mjedisi (në formë kartolinash ose postera me mesazhe për mjedisin), eko-lojërat (gjëgjëzat, lojëra kujtese, formuese etj.), formacione të vogla ose ndryshe klube mjedisor në nivel shkolle (aftësojnë nxënësit të njihen në thellësi me problematika për mbrojtjen e mjedisit), etj. Projekti i fundit mund të shoqërohet me eko-syrin, që synon të bëjë të gjithë nxënësit vigjilentë ndaj shkeljeve të ndryshme në fushën e mjedisit dhe që mund të ketë fushë të gjerë zbatimi veçanërisht në shkollën fillore.

Gjithashtu ide të tjera për aktivitete mjedisore janë edhe krijimi i rrjeteve ekologjike ndërmjet shkollave të ndryshme për të ideuar dhe kryer veprimtari të përbashkëta, seanca publike, në të cilat nxënësit organizojnë dhe shprehin shqetësimet dhe propozimet e tyre për mjedisin, konkurse ndërmjet klasave dhe shkollave për çështje të edukimit mjedisor dhe të mbrojtjes së mjedisit

Bashkërendimi i punës së institucioneve

Përvojat e ndryshme në fushën e

edukimit mjedisor dhe të mbrojtjes së mjedisit dëshmojnë për nevojën e bashkërendimit të forcave për realizimin e edukimit mjedisor në nivel kombëtar dhe vendor. Kjo për faktin se realiteti i edukimit mjedisor është tepër kompleks dhe nuk mund të lihet në përgjegjësinë e një institucioni të vetëm. Rëndësi të madhe ka bashkëpunimi me organet vendorë, që është në interes jo vetëm të shkollës, pra të mësuesve dhe nxënësve por edhe të prindërve. Kjo do të sjellë ndryshime edhe në rolin dhe peshën e aktorëve të ndryshëm shoqërorë dhe në shkallën e kontrollit të ushtruar nga shoqëria civile në këtë fushë.

Rëndësi ka bashkërendimi i veprimtarive ndërmjet OJF-ve dhe institucioneve qeveritare. Kjo merr rëndësi të madhe në kushtet kur bashkëpunimi i shkollave me OJF nuk është në nivelin e kërkuar. .

Në fakt, veprimtaria e bordeve të shkollës nuk është në nivelin e duhur, me gjithë përpjekjet që po bëhen për rritjen e rolit dhe të peshës së autoriteteve vendore dhe e OJF-ve. Ajo që kërkohet është pjesëmarrja e përbashkët në procesin e planifikimit të zhvillimeve lokale, e kërkimit të burimeve për përpunimin e politikave mjedisore në rrethana gjithnjë e më komplekse.

VII. PËRFSHIRJA E MATERIALEVE TË LIBRIT TË MËSUESIT DHE FLETORËS SË NXËNËSIT NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES

Edukimi mjedisor është një nga fushat e rëndësishme të kurrikulës së arsimit fillor për të cilën mësuesit duhet të kujdesen lidhur me planifikimin dhe përfshirjen e veprimtarive në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ndërgjegjësimi i nxënësve për problemet e mjedisit dhe rolit që luajnë individët dhe shoqëritë në shkaktimin e tyre, është shumë i rëndësishme. Mjedisi lokal krijon mundësi për nxënësit që të eksplorojnë shumë manifestime të problemeve globale. Kjo jep mundësi për të krijuar aftësi të caktuara të nxënësit lidhur me veprimet në mjedis përmes përfshirjes në projekte në nivel shkollë, komuniteti apo fushata komunitare.

Përdorimi i librit të mësuesit, fletores së punës së nxënësit dhe çantës së pajisjeve

Pyetja apo dilema që mund të mendojë mësuesin që njihet me paketën e Edukimit Mjedisor dhe që kërkon ta përfshijë atë në kurrikulën e klasës ku ai zhvillon mësim, është “Ku dhe kur do të zhvilloj veprimtari që lidhen me çështjet e mjedisit?” Specialistët dhe mësuesit që kanë tashmë kohë që i trajtojnë problemet mjedisore në kurrikulën e arsimit fillor, tashmë janë të bindur dhe të qartë se rrugët e përfshirjes janë të shumta dhe të larmishme. Këto veprimtari kanë një hapësirë kohore të përcaktuar qartë në planin mësimor të të gjitha klasave të ciklit fillor (një orë në javë për klasat 1-3 dhe 2 orë në javë për klasat 4-5).

Në mbështetje të këtij procesi mësuesve ju vijnë në ndihmë edhe pajisjet e ndryshme që janë shpërndare për të lehtësuar mësimdhënien me metoda më praktike dhe sa më të prekshme nga nxënësit e klasave fillore, të cilët disa koncepte të mjedisit i kanë ende të paqarta.

Në fillim të vitit shkollor, një nga momentet më të rëndësishme të punës së mësuesit, është planifikimi semestral apo vjetor i këtyre veprimtarive. Kjo do të thotë që, në fillim të vitit shkollor mësuesit i duhet të planifikojë temat dhe objektivat që do të zhvillohen me nxënësit në klasën e tij. Në kushtet e një lirie të plotë në këtë proces, kjo punë e mësuesit është sa e thjeshtë aq dhe e vështirë. Është e thjeshtë, sepse ai ka liri të plotë për përzgjedhjen e objektivave, është e vështirë, sepse atij i duhet të zgjedhe tema e objektiva që lidhen dhe përmbushin interesat e nxënësve dhe përputhen me veçoritë e zhvillimit të tyre në atë cikël shkollimi.

Mësuesi mund të planifikojë që në fillim të vitit, një numër të caktuar veprimtarish që i takojnë çështjeve të edukimit mjedisor. Nuk do të quhej gabim dhe do të ishte në përputhje me udhëzimet e përgjithshme kurrikulare, nëse nga mësuesi do preferohej një planifikim me shtrirje gjithëvjetore të veprimtarive që lidhen me edukimin mjedisor. Këtë planifikim e lehtëson shumë materiali i bollshëm që sjellin libri i mësuesit dhe fletoret e nxënësit.

Shembulli i mëposhtëm (Tabela 2) ofron një model planifikimi gjithëvjetor të veprimtarive ekstrakurrikulare me fokus çështjet e edukimit mjedisor.

Megjithatë, mund të ndodhë shpesh që mësuesi të pëlqejë të përfshijë një numër të caktuar veprimtarish që lidhen me heshtjet mjedisore të cilat zënë vetëm një pjesë të planifikimit vjetor të orëve të veprimtarive ekstrakurrikulare. Shembulli i mëposhtëm jep një fragment të planit vjetor i cili është i përqendruar te veprimtaritë që lidhen me çështjet e mjedisit të ofruara nga paketa burimore (libri i mësuesit dhe fletoret e nxënësit) për klasën e pestë. Pa dyshim që sasinë e mbetur të orëve mësuesi e përdor për të planifikuar dhe zhvilluar veprimtari të ndryshme që lidhen me fusha apo tematika të tjera ekstrakurrikulare.

Tabela 2. Plani vjetor i veprimtarive ekstrakurrikulare për klasën e dytë

Moduli	Nr	Tema	Nr. Orëve
Uji	1	Uji dhe shëndeti (LM ¹)	3
	2	Ruajtja e ujit (FPN ²)	1
	3	Përdorimi i ujit (FPN)	1
	4	Këngë për ujin (FPN)	1
Ajri	5	Cilësia e ajrit – Ndotja (LM)	3
	6	Çfarë ndot ajrin në mjedisin rreth shkollës (FPN)	1
	7	Ndikimi mbi shëndetin (LM)	2
Toka	8	Katër stinët (FPN)	1
	9	Toka jonë e bukur (LM)	2
	10	Shpyllëzimi (LM)	3
	11	Të mbjellim një pemë apo bimë (FPN)	1
Natyra	12	Çfarë është natyra (LM)	3
	13	Kolazh me foto të natyrës (FPN)	1
	14	Menaxhimi i mbeturinave (LM)	2
	15	Të ruajmë natyrën nëpërmjet riciklimit (FPN)	1
Ndotja	16	Ndotja dhe ndikimi i saj në mjedis (LM)	3
	17	Ndotja nga zhurmat (LM)	3
	18	Anketë për ndotjen pamore dhe ndotjen nga zhurmat (FPN)	1
	19	Të përdorim qeset plastike që kemi në shtëpi	1
Totali			34 orë³

Tabela 3. Frament plani vjetor i veprimtarive ekstrakurrikulare për klasën e pestë

Moduli	Nr	Tema	Nr. Orëve
Uji	1	Menaxhimi i ujit: Digat dhe rezervuarët (LM)	3
	2	Mbrojtja e ujit (LM)	3
	3	Kujtohuni të mos shpërdoroni ujin (FPN)	1
	4	Fjalëkryq (FPN)	1
Ndotja	5	Çfarë është ndotja dhe format e ndryshme të saj (LM)	3
	6	Ndotja e ujit – shkaqet dhe pasojat (LM)	3
	7	Ndotja e ajrit – shkaqet dhe ndikimet (LM)	3
	8	Lexim gazete dhe hartim (FPN)	1
	9	Marrja e një zotimi dhe krijimi i një posterit (FPN)	1
Totali			19 orë

Duket qartë se shembulli i mësipërm është përqendruar në dy module të edukimit mjedisor të prezantuar përmes kësaj pakete, atë të ujit dhe të ndotjes. Kjo do të thotë se mësuesi mund të përzgjedhë ato veprimtari apo module nga materiali burimor, që i duken të

përshtatshme për nevojat dhe interesat e nxënësve të tij. Po kështu mësuesi është i lirë të trajtojë çështjet mjedisore në aq orë mësimore përgjatë një viti sa ai i sheh të përshtatshme për klasën ku zhvillon mësim.

Veprimtaritë dhe objektivat e edukimit mjedisor mund të përfshihen me shumë sukses dhe efektivitet në hapësirën e orëve të lira të secilës kurrikul lëndore apo dhe fushave lëndore. Mësuesit janë njohur me nënvizimit që i bëhet kësaj mënyrë të përfshirjes së edukimit mjedisor në kurrikulen e arsimit fillor, në Udhëzimin e MASH për fillimin e vitit shkollor 2008-2009, ku duket se përfshirja në hapësirën e orëve të lira shihet si mënyrë e mirë dhe e sugjeruar për të përfshirë objektivat dhe veprimtaritë e edukimit mjedisor në kurrikul.

Para sfidës së madhe që ka mësuesi në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve kurrikulare, moduleve kurrikulare, veprimtarive ekstrakurrikulare etj, në kuadrin e orëve të lira, tematikat dhe çështjet mjedisore do të ishin ide shumë të vlefshme dhe të efektshme për t'u përdorur. Fushat dhe çështjet mjedisore gjejnë vend dhe lidhen me shumë fusha kurrikulare. Kjo bën që objektivat dhe veprimtaritë që sjell paketa (libri i mësuesit dhe fletorja e punës e nxënësit) të jenë një burim i vlefshëm për realizimin e objektivave në kuadrin e orëve të lira.

KUTIA 1

Shembull 1

Në klasën e katërt, në lëndën e diturisë së natyrës, në dy kapitujt e parë trajtohen çështje të rëndësishme dhe jo pak të lehta për fëmijët e asaj moshe si atmosfera, reshjet, ndotësit e mjedisit dhe shirat acidë. Dy çështjet e fundit janë komplekse dhe mësuesi mund ta shohë si të përshtatshme që, në fund të kapitullit të dytë, të planifikonte një projekt lidhur me ndotjen e ajrit.

Duke shfrytëzuar librin e mësuesit të paketës së edukimit mjedisor, mund të përzgjedhë veprimtari që do të përcillen si një projekt dhe do të shërbejë që nxënësit të thellohen më tej dhe të qartësohen më mirë rreth atyre çështjeve. Kështu për rreth 2-3 orë mësimore mund të zhvillohet me nxënësit në projekt kërkimor duke u bazuar në objektivat dhe idetë që përcillen në librin e mësuesit përmes veprimtarive: "Çfarë është ndotja dhe cilat janë format e ndotjes"⁴ dhe "Ndotja e ajrit – shkaqet dhe ndikimi"⁵.

Po kështu libri i mësuesit shërben si një material i mirë burimor për mësuesin për të marrë më shumë informacion shkencor dhe fakte mbi problemet e ndotjes, shirat acidë etj.

Shembull 2

Një shembull tjetër mund të jetë rasti i kurrikulës së gjuhës dhe edukatës shoqërore në klasën e dytë. Në lëndën e gjuhës zhvillohet tema "Fëmijët dhe ambienti" e cila përveç objektivave gjuhësor dhe të leximit përmbush dhe objektiva mjedisore duke trajtuar problemin e ndotjes së mjedisit nga plehrat. Po kështu në lëndën e edukatës shoqërore zhvillohen tema si "Rregullat në klasë", "Rregullat në familje" në të cilat trajtohen gjerësisht dhe problemet e mbajtjes pastër të mjedisit të klasës dhe familjes.

Pasi ka zhvilluar këto tema mësuesi mund të shohë të përshtatshme dhe të vlefshme të ndalet në rreth 2-3 orë mësimore dhe të bëjë disa veprimtari me nxënësit në formën e një projekti kurrikular kërkimor me tematikë çështje mjedisore si ndotja nga plehrat, riciklimi i tyre, etj. Për këtë ai mund të gjejë material të bollshëm si për vete ashtu dhe nxënësit në paketën e edukimit mjedisor, duke i shfrytëzuar objektivat dhe veprimtaritë për t'i zhvilluar me nxënësit në klasën e tij. Kështu, në këtë rast do të ishin të përshtatshme veprimtaria: "Menaxhimi i mbeturinave"⁶ dhe "Riciklimi"⁷, nga libri i mësuesit.

Në *Kutinë 1* janë dhënë dy shembuj projektesh kurrikularë lidhur me tematika mjedisore që lidhen edhe me kurrikulat lëndore në klasa dhe lëndë të ndryshme të ciklit fillor.

Shembujt e *Kutisë 1* paraqesin rastin kur projektet kurrikulare në kuadrin e orëve të lira planifikohen dhe zhvillohen brenda kurrikulave lëndore apo fushave kurrikulare.

Siç është theksuar edhe më lart çështjet mjedisore mund të trajtohen edhe përmes projekteve kurrikularë të zhvilluara në nivel shkolle në kuadrin e orëve të lira. Nga përvoja e deritanishme është parë që shpesh shkollat dhe mësuesit preferojnë të zhvillojnë veprimtari në nivel shkolle duke përfshirë shumë klasa njëherësh.

Shembujt në *Kutinë 2* tregojnë rastin kur çështjet e edukimit mjedisor përcillen përmes veprimtarive të zhvilluara në kuadër të projekteve shkollor

Këto janë disa nga rrugët kryesore të përfshirjes së materialeve që përmban libri i mësuesit dhe fletoret e nxënësit në kurrikulën e arsimit fillor.

Përzgjedhja e veprimtarive nga libri i mësuesit dhe fletoret e punës së nxënësit

Para se të bëhet përzgjedhja e veprimtarive nga materialet burimore të ofruara, duhen përcaktuar kriteret me të cilat do të vlerësohet dhe do të përzgjidhet veprimtaria. Problemi është që të njihen mundësitë dhe kufizimet që ofron veprimtaria, në mënyrë që të bëhet një zgjedhje e përshtatshme.

Më poshtë jepen shtatë kritere për përzgjedhjen e veprimtarive, që mund të zhvillohen.

KUTIA 2

Shembull 1

Shkolla mund të planifikojë dhe të organizojë një sërë veprimtarish në kuadrin e “Javës së mjedisit”. Java e mjedisit mund të jetë një javë e caktuar në vit gjatë së cilës mësuesit e disa klasave kanë menduar të zhvillojnë disa veprimtari lidhur me çështjet e mjedisit. Për këtë mësuesit janë mbledhur paraprakisht nën udhëheqjen e kryetarit kurrikular dhe kanë planifikuar veprimtaritë që do të zhvillohen.

Në këtë kuadër, mund të organizohen ekskursione, ekspozita me punime të nxënësve, takime me specialistë të mjedisit, pastrim dhe gjelbërim i mjedisëve të shkollës, etj. Për të realizuar me efektivitet këto veprimtari mund të përdoret libri i mësuesit dhe fletoret e punës së nxënësve të paketës burimore të edukimit mjedisor të cilat ofrojnë një informacion të bollshëm dhe veprimtari të shumta lidhur me çështje të ndryshme mjedisore.

Shembull 2

“Në ditën ndërkombëtare të Tokës” (22 Prill) shkolla mund të vendosë të zhvillojë një veprimtari për të gjithë nxënësit e ciklit fillor. Në këtë veprimtari mësuesit ndihmojnë nxënësit të bëjnë një sërë veprimtarish sa argëtuese aq dhe informuese lidhur me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me problemet mjedisore të tokës. Për këtë mund të shfrytëzohen materialet e librit të mësuesit⁸.

1. Rezultati i synuar

- Cili është qëllimi i veprimtarisë?
- Cilat janë rezultatet që do të dëshironit të arrinit?

2. Numri

- Për sa vetë është hartuar veprimtaria?
- Kërkon punë në grupe apo çifte?
- Si mund t'i ndani nxënësit për të pasur përfitim maksimal?

3. Interesi

- A ngjall interes veprimtaria?
- A është e re apo e njohur më parë?
- A kanë lidhje çështjet që po trajtoni me lëndët e tjera?
- A munden nxënësit të bëjnë lidhjen me çështjet e trajtuara në lëndët e tjera?

4. Menaxhimi

- A mund të vëzhgohet me lehtësi veprimtaria?
- A mund të angazhoni persona të tjerë si vëzhgues?
- A keni nevojë për trajnim apo përvojë paraprake për ta zhvilluar veprimtarinë?

5. Koha dhe kostoja

- A mund të zhvillohet veprimtaria me sukses brenda kufirit kohor që keni në dispozicion?
- A ka kohë të mjaftueshme për hapjen dhe mbylljen e veprimtarisë?
- A bëni dallimin mes kostos aktuale të veprimtarisë dhe vlerës së vërtetë që ajo

ka për nxënësit tuaj?

6. Thjeshtësia

A • kuptohet me lehtësi veprimtaria nga nxënësit tuaj?

- A është niveli intelektual i lojës i përshtatshëm për nxënësit tuaj?

7. Mbyllja (përmbushja)

- Si mendoni ta mbyllni veprimtarinë me nxënësit?
- A i keni mjetet dhe aftësitë e duhura për mbylljen e veprimtarisë, duke u siguruar që nxënësit morën vlerat maksimale?

Qëllimet edukative të veprimtarive të edukimit mjedisor

Para se mësuesi të punojë me materialin shkencor veprimtaritë e përfshira në librin e mësuesit, është shumë e rëndësishme të kuptojë vlerën edukative të tyre. Edukimi mjedisor është edukim për të të ndryshuar, si individualisht, ashtu edhe shoqërisht. Ai mundëson zhvillimin e kompetencave të nxënësve me synimin që ata të bëhen qytetarë aktivë të cilët marrin pjesë në komunitetet e tyre për të promovuar dhe mbrojtur çështjet e mjedisit. Fokusi ynë është zhvillimi i njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë fushë. Në këtë proces:

- fillohet nga ajo që nxënësit dinë, nga opinionet dhe eksperiencat e tyre dhe nga kjo bazë, inkurajohen të kërkojnë dhe të zbulojnë së bashku ide dhe eksperiencat e reja;

- inkurajohet pjesëmarrja e nxënësve për të kontribuar në diskutime dhe për të nxënë nga njëri tjetri sa më shumë që të jetë e mundur;
- inkurajohen nxënësit të shfaqin të nxënit në veprime të thjeshta, por efektive, që demonstronë reagimin e tyre ndaj padrejtësisë, pabarazisë dhe dhunimit të të drejtave të njeriut.

Kompetenca të tilla si, aftësitë e komunikimit, të menduarit kritik, toleranca dhe respekti, nuk mund të mësohen veçse përmes përvojës. Kjo është arsyeja që, veprimtaritë në këtë manual nxisin bashkëpunimin, pjesëmarrjen dhe të nxënit pikërisht përmes saj. Qëllimi është të nxiten nxënësit të mendojnë, ndjejnë dhe veprojnë, të angazhojnë mendjet, zemrat dhe duart.

Të nxënit bashkëpunues

Një nga qëllimet kryesore edukative të veprimtarive të edukimit mjedisor është të nxënit bashkëpunues. Kjo ka të bëjë me të punuarit së bashku, për të arritur qëllime të përbashkëta. Në të nxënit bashkëpunues nxënësit punojnë bashkë për të arritur diçka që është në interesin si të individit ashtu edhe të të gjithë pjesëtarëve të tjerë të klasës.

Bashkëpunimi është një tipar dallues i edukimit mjedisor. Ai siguron arritje dhe produktivitet të lartë, marrëdhënie pozitive dhe mbështetëse, shëndet psikologjik dhe kompetenca sociale e vetëvlerësim.

Elementët bazë të bashkëpunimit janë: ndërvarësia pozitive, bashkëpunimi ballë për ballë dhe aftësitë ndërpersonale. Rruga më efektive, për të siguruar të nxënit bashkëpunues, është përmes punës në grupe të strukturuar.

Pjesëmarrja

Pjesëmarrje në edukimin mjedisor do të thotë që nxënësit marrin vendime se çfarë dhe si do të mësojnë rreth çështjeve mjedisore. Përmes pjesëmarrjes ata zhvillojnë kompetenca të ndryshme, duke përfshirë ato të vendimmarrjes, të dëgjuarit dhe respektit për të tjerët si dhe marrjen e përgjegjësisë për vendimet dhe veprimet e tyre. Roli i mësuesit është ai i "lehtësuesit", i cili ndihmon apo lehtëson pjesëmarrjen e nxënësve në procesin e të nxënit.

Të gjitha këto tregojnë se, detyra kryesore në edukimin mjedisor është gjetja e hapësirës ku nxënësit të bëhen pjesëmarrës aktivë dhe të ndikojnë në formën dhe rezultatet e veprimtarisë.

Të nxënit përmes përvojës

Edukimi mjedisor, ashtu si dhe edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi për paqe etj, përdor si metodologji atë të të nxënit përmes përvojës, bazuar në një cikël të nxëni me pesë faza të cilat janë: përvoja, zbatimi, raportimi, reflektimi dhe përgjithësimi. Në fazën e fundit nxënësit eksplorojnë dhe zbatojnë veprime praktike, që i adresohen çështjeve të ndryshme mjedisore. Është thelbësore që nxënësit të gjejnë mundësi për t'u përfshirë në veprime konkrete.

Motivimi i nxënësve

Nxënësit në klasat ku zhvillohen veprimtaritë e edukimit mjedisor mësojnë dhe nxënë më mirë atëherë kur janë të motivuar. Kjo ndodh atëherë kur ata:

- Janë të qartë për veprimtaritë që po kryejnë dhe qëllimin që ato kanë;
- Mund të punojnë vetë duke u

mbështetur në njohuritë që ata vetë kanë;

- Marrin pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të veprimtarive duke krijuar hapësirë që të përdorin gjuhën dhe perceptimet e tyre për të kuptuar.

Përveç kësaj, nxënësit që marrin pjesë në këto veprimtari do të përfshiheshin më aktivisht në veprimtaritë e zhvilluara në qoftë se ata:

- Kanë një mjedis të përshtatshëm dhe i siguron mundësi të punojnë së bashku me të tjerët dhe po ashtu e çliron nga presioni i notës apo i gabimit;
- Kanë një sërë mundësi zgjedhjesh për çfarë, kur dhe si duan të mësojnë;
- Kanë kohë të mendojnë dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar.

Disa veçori të planifikimit dhe procesit të mësimdhënies të edukimit mjedisor

Objektivat që përcaktohen në materialin burimor nuk janë të detyrueshme të zbatohen siç ndodh me objektivat lëndorë. Kjo do të thotë se mësuesi mund të planifikojë ato objektiva që ai i mendon më të përshtatshme për nxënësit. Ai gjithmonë bën kujdes që të përcaktojë objektiva që lehtësojnë dhe përmirësojnë të nxënësve në edukimin mjedisor.

Veprimtaritë kanë në dispozicion hapësirë kohore që është fleksibël. Kjo do të thotë se përmbushja e një objektivi të caktuar mund të shtrihet në aq orë mësimore sa mësuesi e sheh të përshtatshme për klasën e tij. Kjo do të bëjë që nxënësit të përvetësojnë më

mirë dhe të aftësohen lidhur me çështjet që trajton veprimtaria.

Aplikimi i veprimtarive të edukimit mjedisor bëhet në kushtet kur nuk ka shumë traditë. Ajo është e re dhe e brishtë. Edukimi mjedisor na shkollat tona është në hapat e parë. Kjo bën të mundur që mësuesit duhet të përpiqen dhe të aftësohen për të qenë efektiv në mësimdhënie.

Pavarësisht se në librin e mësuesit janë të qarta klasat ku zhvillohen veprimtaritë, ato shpesh nuk janë të lidhur me një nivel të caktuar shkollimi. Kjo do të thotë, se ndodh shpesh që nxënësit pavarësisht nga mosha marrin pjesë në të njëjtën veprimtari dhe realizojnë të njëjtët objektiva.

Për arritjet e nxënësve në këto veprimtari nuk ka vlerësim me notë. Kjo do të thotë që ky është një nga rastet e vetme kur nxënësi është i çliruar nga presioni i notës. Kjo e bën mësimin më të "rehatshëm" për nxënësin dhe mësuesit.

Aplikimi i veprimtarive që lidhen me çështjet e mjedisit shihet si mundësi për të afruar disiplinat e mirëfillta shkencore me problemet bashkëkohore. Kjo do të thotë se mësuesit përpiqen që dhe disiplinat më akademike dhe "të vështira" për nxënësit të përcillen lehtë te ata përmes gërshetimit të njohurive që ata përmbajnë me problemet sociale të prekshme nga fëmijët.

VIII. VLERËSIMI I SITUATËS MJEDISORE NË SHKOLLË DHE KOMUNITET

Çfarë do të thotë vlerësim?

Çfarë do të thotë “të vlerësosh”? Në gjuhën e thjeshtë do të thotë të çmosh vlerën e diçkaje, ndërsa, në lidhje me edukimin mjedisor, do të thotë të çmosh vlerën e nismës së edukimit mjedisor të nisur tashmë në shkollë. Kjo mund të ketë kuptimin e vlerësimit të një seance 2-orëshe, një seminari njëjavor ose një projekti njëvjeçar për situatën mjedisore, që përfshin disa komponentë.

Pse lind nevoja e vlerësimit?

Kur pyesim njerëz pse duhet të vlerësojmë atë që bëjmë, ne marrim përgjigje të ndryshme. Ja disa nga përgjigjet që japin njerëzit:

- Për të parë çfarë kemi arritur në lidhje me objektivat që filluam.
- Për të parë nëse puna jonë pati efektin e dëshiruar.
- Për të gjetur pikat e forta dhe të dobëta.

A sheh vlerësimi vetëm në të kaluarën?

Shumë njerëz e pranojnë që vlerësimi është shumë i dobishëm për të ecur përpara dhe për të bërë plane për të ardhmen. Në të vërtetë, shumë projekte dhe iniciativa planifikohen pas bërjes së vlerësimit.

- Ndhmon të shikojmë ku po shkojmë dhe të bëjmë ndryshimet e nevojshme.
- Ndhmon, gjithashtu, të jemi më të dobishëm nën dritën e pikave të forta dhe të dobëta.

Cilat janë dy aspektet kryesore të vlerësimit?

Shumica e vlerësimeve kanë të bëjnë

me gjërat që numërohen ose maten. Ky është aspekti sasior i vlerësimit, i cili është gjithashtu i rëndësishëm për vlerësimin e situatës mjedisore në shkollë dhe komunitetin rreth saj. Për shembull, ne mund të përcaktojmë:

- numrin e njerëzve të përfshirë në edukimin mjedisor;
- numrin e programeve;
- numrin e fshatrave/qyteteve/rretheve/komuniteteve që mbulohen nga programi;
- numrin e sektorëve që mbulohen nga ky programi (p.sh.: fëmijët, prindërit, mësuesit etj.);
- sasinë e materialeve të prodhuara.

Megjithatë nuk është e mjaftueshme të përcaktojmë vetëm faktorët që mund të numërohen dhe të maten për vlerësimin e situatës mjedisore në shkollë dhe në komunitet. Vlerësimi ka edhe aspektin cilësor, i cili përfshin:

- ndryshimet në motivimin e njerëzve për tu kujdesur dhe për t'u marrë me problemet mjedisore;
- vlerat, qëndrimet që ka krijuar edukimi mjedisor tek fëmijët dhe prindërit;
- aftësitë, njohuritë e formuara pas përfundimit të edukimit mjedisor.

Kush mund të bëjë vlerësime?

Përgjithësisht, shumë njerëz mendojnë se janë “ekspertët” ata që e bëjnë më mirë vlerësimin dhe është e vërtetë se këto vlerësime ndihmojnë, por vetëm kjo nuk do të ishte e mjaftueshme. Prandaj është e rëndësishme që të gjithë njerëzit e përfshirë, të ndikuar nga ky vlerësim të jenë gjithashtu pjesë e procesit të

vlerësimit. Në programin e edukimit mjedisor përfshihen:

- pjesëmarrësit e programit (fëmijët dhe mësuesit);
- organizatorët (drejtuesit e shkollës dhe anëtarët e projektit)
- njerëzit dhe institucione të tjera të interesuara (kryetarët e komunitetit, përfaqësuesit e qeverisë, mësues dhe drejtues shkollash etj.);
- anëtarë të komunitetit.

Është e rëndësishme që këta njerëz janë përfshirë në vlerësimin aktual, si dhe në analizimin dhe raportimin. Vlerësimi është për të gjithë ata dhe jo për ndokënd tjetër. Megjithatë, ashtu siç thamë edhe më lart, vlerësimet e bëra nga njerëz dhe grupe që nuk janë të përfshira në program dhe që nuk kanë ndonjë interes për programin, janë gjithashtu të dobishme, sepse ata mund të jenë më objektivë dhe më pak paragjykses. Ky quhet vlerësim i jashtëm.

Kur duhet të bëhet vlerësimi?

Mendimi i përgjithshëm është se vlerësimi duhet të bëhet në fund të programit. Kjo është e vërtetë, por pjesërisht. Tani shumë programe po bëjnë vlerësime të herëpashershme, si për shembull: Në një shkollë që zhvillon veprimtari të edukimit mjedisor mund të bëhen vlerësime pas çdo mësimi ose në fund të çdo muaji.

Në një program njëditor të edukimit mjedisor vlerësimi mund të bëhet në fund të programit. Në rastin e seminareve të edukimit mjedisor është e zakonshme të shpenzohen disa minuta në fund të çdo dite për të rishikuar ditën

e punës, por një vlerësim më serioz dhe më i kuptueshëm bëhet në fund të seminarit.

Kur kemi parasysh një projekt të edukimit mjedisor për një periudhë të caktuar, le të themi, një vit, do të ishte mirë të bëheshin vlerësime të rregullta (mujore/tremujore) të ndjekura nga një vlerësim në fund të projektit.

Cilat janë metodat që mund të përdoren për të bërë vlerësimin?

Për të ndjekur metodën e përgjithshme të vlerësimit të trajnimeve të edukimit mjedisor, ne duhet ta bëjmë vlerësimin me sa më shumë pjesëmarrës. Metoda të ndryshme mund të përdoren në vlerësimin e një programi të edukimit mjedisor. Disa nga metodat më të njohura janë:

- pyetje dhe përgjigje verbale të pjesëmarrësve;
- intervista me pjesëmarrësit si dhe me palë të tjera të interesuara;
- diskutime në grup;
- efekti i shpejtë;
- pyetësorë të shkruar;
- analiza të informacionit ekzistues si janë statistikisht;
- vëzhgime;
- përdorimi i fotove;
- përdorimi i shkallës vlerësuese, p.sh., nga 1-5 ose me më shumë shkallë që tregojnë nga niveli më i ulët deri te më i larti.

Më poshtë janë disa faktorë që duhet të kihen parasysh në zgjedhjen e metodave të përshtatshme të vlerësimit, të tillë si:

- objektivat e vlerësimit,
- fazën e projektit/ programit kur duhet të ndodhë vlerësimi,
- kush duhet të përfshihet në vlerësim.

Si planifikohet vlerësimi ?

Suksesi i vlerësimit varet në masë të madhe nga planifikimi i mirë dhe, në këtë rast, edhe për vlerësimin një gjë e tillë nuk është përjashtim. Vlerësimi duhet të planifikohet paraprakisht, duke pasur parasysh faktorët e përmendur më sipër.

Ç'është një cikël vlerësimi?

- caktimi i objektivave të vlerësimit;
- caktimi se kur / si (metodat e vlerësimit);
- kryerja e vlerësimit;
- shikimi i rezultateve (analiza);
- përdorimi i rezultateve për të ndikuar programin

A është i rëndësishëm një vlerësim i nevojave të trajnimit?

Para fillimit të një programi të edukimit mjedisor, është e rëndësishme të vlerësohet realiteti i mjedisit të shkollës dhe të komunitetit. Në pajtim me trajnimin aktiv që në po përdorim, është më mirë nëse lëmë vetë komunitetin / përfituesit të identifikojnë nevojat e tyre për trajnim – kjo mund të ishte baza për zhvillimin e një programi të përshtatshëm të edukimit mjedisor që do t'u përgjigjej nevojave të komunitetit.

Cili është roli i treguesve në vlerësim?

Një tregues është si një shenjë rrugore. Është njësoj si një shenjë qarkullimi rrugor që tregon nëse jemi në rrugë të drejtë dhe nëse kemi marrë drejtimin e duhur, sa kemi ecur dhe sa duhet te ecim për të arritur në destinacion.

Një program i edukimit mjedisor është njësoj si një udhëtim. Na duhet të kontrollojmë herë pas here që po ecim drejt vendit ku duam të mbërrijmë (objektivi), cili është progresi që kemi bërë dhe nëse kemi bërë progresin e duhur brenda një periudhe kohe të caktuar. Kjo na jep edhe epërsinë për të ndryshuar drejtimin në mes të rrugës, nëse është e nevojshme, në vend që të presim deri në fund. Për një program të edukimit mjedisor, është e rëndësishme të identifikohen treguesit për fazat e caktuara të programit. Më poshtë po japim disa shembuj:

Treguesit cilësorë

Njohuritë:

- Aftësia e fëmijëve për të paraqitur njohuritë e mësuara në aktivitetet e edukimit mjedisor.
- Aftësia për të shpjeguar koncepte që lidhen ngushtë me natyrën, ajrin, pyjet, tokën duke i lidhur me situata të jetës së tyre të përditshme
- Aftësia për të dhënë alternativa të ndryshme zgjidhjeje për probleme të mjedisit

Aftësitë:

- Aftësia e fëmijëve për të përdorur lojëra simulimi për të mësuar rreth mjedisit.
- Aftësia për të identifikuar

problemet mjedisore në komunitetin/vendin e tij/e saj.

- Aftësia për të reaguar kundrejt dëmtimeve mjedisore në komunitetin e tij /e saj .
- Aftësia për të shkruar letra proteste kundër situatave problematike mjedisore.

Qëndrimet/Vlerat

- Shfaq interesa të lartë në çështjet mjedisore
- Është më shumë i përfshirë në çështje të edukimit mjedisor
- Ka ndjeshmëri më të lartë për problemet mjedisore.

(referenca)

¹ LM është shkurtimi i Librit të Mësuesit dhe tregon se tema është përzgjedhur nga manuali i mësuesit dhe grupi i veprimtarive për klasën 1&2 të secilit modul

² FM është shkurtimi i Fletorja e punës së Nxënësit dhe tregon se tema është përzgjedhur nga fletorja e punës së nxënësit për klasën e dytë.

³ Duke ditur që totali i orëve në dispozicion është 35 ore, një orë ose më shumë mësuesi mund ta lërë në dispozicion për nevojat gjatë vitit

⁴ "Edukimi mjedisor – Libri i mësuesit", faqe 340

⁵ "Edukimi mjedisor – Libri i mësuesit", faqe 348

⁶ "Edukimi mjedisor – Libri i mësuesit", faqe 245

⁷ "Edukimi mjedisor – Libri i mësuesit", faqe 190

⁸ "Edukimi mjedisor – Libri i mësuesit", faqe 158 – 161; faqe 207

shtojcat

SHTOJCA 1

VLERËSIMI I RESPEKTIMIT DHE I MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR NË SHKOLLË DHE NË KOMUNITET

Veprimtaria:

Situata mjedisore në shkollë dhe në komunitetin rreth saj

Qëllimi:

Kjo veprimtari synon t'i ndihmojë mësuesit dhe fëmijët të vëzhgojnë, të vlerësojnë respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor në shkollën e tyre.

Objektivat:

Në fund të realizimit të kësaj veprimtarie pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë:

- Të hartojnë projekte për mbikëqyrjen e situatës mjedisore në shkollën e tyre.
- Të vëzhgojnë realizimin e përgjegjësive të fëmijëve në lidhje me mjedisin
- Të hartojnë pyetësorë për mësuesit, nxënësit dhe prindërit.
- Të realizojnë intervista dhe anketa në shkollë.
- Të plotësojnë raporte për zbatimin dhe respektimin e kushteve mjedisore në shkollë.
- Të publikojnë rezultatet e përpunuara që lidhen me edukimin mjedisor në shkollë.

Pjesëmarrës:

Në këtë veprimtari duhet të marrin pjesë:

- një drejtues i shkollës (zakonisht zëvendësdrejtori);

- përfaqësues (mësues, nxënës ose prindër) nga organizmat e ndryshëm në shkollë, si këshilli i klasës, qeveria e nxënësve, këshilli i disiplinës, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve;
- përfaqësues (nxënës) nga çdo klasë e shkollës, si në ciklin fillor, ashtu edhe në ciklin e lartë;
- përfaqësues (prindër) nga komuniteti i shkollës;
- një specialist i ftuar, i njohur në fushën e vlerësimit në arsim.

Në varësi të numrit të mësuesve, të fëmijëve të shkollë caktohet numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këtë projekt, të cilët duhet të ndahen në grupet e mëposhtme:

- **Grupi I** i hartimit dhe i realizimit të instrumenteve që do të vëzhgojë zbatimin e rregullave që lidhen me kujdesin ndaj mjedisit në shkollë me anë të pyetësorëve, të anketave dhe të intervistave, të lidhura me:
 - *sa i njohin rregullat e mjedisit fëmijët;*
 - *sa i zbatojnë ato në shkollë;*
 - *sa i njohin këto rregulla mësuesit, drejtuesit e shkollës;*
 - *sa komunikojnë fëmijët me mësuesit, prindërit dhe me njëri-tjetrin për probleme mjedisore;*
 - *sa punohet në shkollë për respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit*
- **Grupi II** që do të vëzhgojë materialet e shkollës, planifikimet e saj, përfshirjen e çështjeve mjedisore në to, mjedisin e shkollës, lidhur me:
 - *sa është i përfshirë në planet e zhvillimit të shkollës trajtimi*

i edukimit mjedisor;

- sa veprimtari të edukimit mjedisor planifikojnë mësuesit;
- sa rrezaton respektimi dhe mbrojtja e mjedisit të shkollës;
a ka mjedise të veçanta për zhvillimin e edukimit mjedisor.

- **Grupi III** që do të kontaktojë me prindër, familje dhe me anëtarë të tjerë të komunitetit, lidhur me:
 - *sa prindërit i njohin problemet mjedisore në zonën ku jetojnë*
 - *si punojnë ata për respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit të tyre jetësor;*
 - *sa punon komuniteti për zbatimin dhe mbrojtjen e mjedisit të tyre.*
- **Grupi IV** që do të merret me shkrimin e raportit përfundimtar, pas përpunimit të të dhënave, raport, i cili duhet të lidhet me qëllimin e projektit, si dhe me realizimin e objektivave të përcaktuar më parë. Në këtë raport sugjerohet të punojnë mësues të shkollës, specialisti i ftuar i vlerësimit, prindër, të cilët janë figura të njohura ose që kanë kontribute në fushën e edukimit mjedisor, si dhe nxënës të aftë për të kryer veprimtari të tilla.

Materiale të nevojshme:

Instrumentet e përgatitura (pyetësorë, anketa, intervista) të gjitha të shumëfishohen për numrin e caktuar të atyre që do ta plotësojnë. Stilolapsa, blloqe, ngjyra të ndryshme, kompjuter.

Koha e nevojshme për realizimin e projektit: Një semestër (3-4 muaj)

Procedura:

Hapi I

Paraqitja e kësaj veprimtarie ose projektit nga pjesëmarrësit në shkollë, në çdo klasë, në takimet me prindërit, me komunitetin ose mund të vendosen në një stendë të dukshme në shkollë të gjitha fazat, qëllimet, objektivat që synon të arrijë ky projekt.

Hapi II

Të gjithë nxënësve, mësuesve, prindërve, drejtuesve të shkollës, të cilët do të marrin pjesë në këtë veprimtari u kërkohet të plotësojnë fletën e punës 1 (Çfarë presim ne nga projekti).

Hapi III

Secili grup do të punojë sipas detyrave për të cilat janë krijuar, si:

Grupi I-Hartimi i pyetësorëve, anketave dhe intervistave, realizimi i tyre me mësues, fëmijë, prindër.

Grupi II-Do të mbledhë materiale të drejtorisë së shkollës, të mësuesve dhe të nxënësve për të vëzhguar përfshirjen e edukimit mjedisor në to.

Grupi III-Do të vëzhgojë dhe do të intervistojë prindër dhe anëtarë të tjerë të komunitetit lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Grupi IV- Do të vëzhgojë raste të ndryshme në orë mësimore, në veprimtaritë brenda ose jashtë shkollës që lidhen me realizimin e detyrave dhe të përgjegjësive që duhet të realizojnë fëmijët ndaj mjedisit.

Grupi V-Do të punojë për përgatitjen e strukturës përfundimtare të raportit që do të hartohet.

Hapi IV

Në këtë fazë do të plotësohen pyetësorët, intervistat, anketat me të gjithë pjesëmarrësit e paracaktuar. Do të përpunohen të dhënat e nxjerra nga

materialet e shkollës, nga drejtoria, nga mësuesit etj.

Hapi V

Të gjitha materialet e grumbulluara, të cilat do të përgatiten në varësi dhe në përputhje me strukturën e raportit që u është dhënë më parë grupeve të punës, dorëzohen tek grupi V, i cili do të punojë për materialin përfundimtar.

Hapi VI

Do të ketë tryeza të rrumbullakëta, diskutime debate rreth materialit që është përgatitur nga grupi V, bazuar në materialet e grupeve I-IV, si dhe do të plotësohet nga reflektimet e mundshme.

Hapi VII

Publikimi i raportit përfundimtar në një takim të zgjeruar me mësues, fëmijë, prindër, si dhe në stendën përkatëse në shkollë. Mund të shfrytëzohet edhe media e shkruar, lokale ose elektronike.


Krahasimi i rezultateve të arritura me idetë e shprehura në fletën 1 të punës.

Shpallja e objektivave të arritur si dhe përcaktimi i detyrave që duhen plotësuar në të ardhmen në fushën e Edukimit Mjedisor në shkollë.

MATERIALE NË NDIHMË TË VEPRIMTARIVE

1. Fletë pune: Çfarë presim në fund të kësaj veprimtarie?

Kjo mund të plotësohet nga të gjithë pjesëmarrësit, pasi është paraqitur projekti për t'u zbatuar.

Lexoni fjalitë!	Nëse jeni dakord, vendosni X
– Kjo veprimtari do të më ndihmojë të kuptoj dhe të zhvilloj njohuritë e mia për mjedisin	<input type="checkbox"/>
– Kjo veprimtari do të më mësojë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që më takojnë ndaj mjedisit.	<input type="radio"/>
– Kjo veprimtari do t'i ndihmojë njerëzit të respektojnë dhe të mbrojnë mjedisin ku jetojnë.	<input type="checkbox"/>
– Kjo veprimtari do të mbështetë të drejtat e fëmijëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm.	<input type="radio"/>
– Kjo veprimtari do t'i japë komunitetit tonë, në shkollë dhe më gjerë, më shumë mundësi për veprimtari pozitive në drejtim të mjedisit.	<input type="checkbox"/>
– Kjo veprimtari do të bëjë që njerëzit të jenë më të vetëdijshëm rreth çështjeve mjedisore	<input type="radio"/>
– Kjo veprimtari do t'i stimulojë njerëzit për të punuar më shumë në fushën e edukimit mjedisor në Shqipëri.	<input type="checkbox"/>
Kjo veprimtari do të ... (vazhdoni më tej vetë, nëse keni ide ose deklarime të tjera)	

2. Pyetësor për fëmijët.

Nr.	Lexoni me kujdes!	Shënoni ose qarkoni.
1	Shkruani disa rregulla për mjedisin që i zbatoni në shkollën tuaj.	 _____ _____ _____
2	Shkruani disa rregulla që i zbatoni në familjen tuaj.	 _____ _____ _____
3	Shkruani disa të drejta që lidhen me mjedisin ku jetoni, të cilat mendoni se ju shkelen në shkollë, në shtëpi ose në komunitetin tuaj.	 _____ _____ _____
4	A keni marrë pjesë në veprimtari për edukimin e mjedisor në shkollë?	 Qarkoni PO JO. Nëse po, vendosni X (anash) Asnjëherë ____ Rrallëherë ____ Shpeshherë ____ Gjithmonë ____
5	Në lagjen tuaj, a keni mjedise të përshtatshme për të luajtur dhe për të bërë veprimtari të ndryshme.	 Qarkoni PO JO. Nëse po, çfarë veprimtarish zhvilloni. Shkruani disa: _____ _____ _____
6	Cilat përgjegjësi ose detyra i konsideroni të rëndësishme për mjedisin ku jetoni në shkollë, në shtëpi, në lagjen tuaj?	 _____ _____ _____
7	A merrni pjesë në këshilla të ndryshëm ose në grupime që formojnë fëmijët për probleme mjedisore?	 Qarkoni PO JO . Nëse po, në cilat: _____ _____ _____

3. Pyetësor për prindërit.

Nr	Fëmija juaj	Asnjëherë	Rrallëherë	Shpeshherë	Gjithmonë
1	I kryen rregullat që lidhen me mjedisin? Shënoni X tek njëra nga alternativat.				
2	Mban pastër mjedisin e tij në shtëpi dhe në shkollë.				
3	Lexon libra, gazeta ose materiale jashtëshkollore që trajtojnë tema mjedisore.				
4	Argëtohet me shokët/shoqet në lagjen e tij.				
5	Diskuton me ju rreth temave të mjedisit si toka, ajri, uji, natyra, zhurmat etj				
6	Zhvillon në shkollë veprimtari për edukimin mjedisor				
7	Ju fton të merrni pjesë në veprimtaritë mjedisore të shkollës.				
8	Ju, si prindër, a keni marrë pjesë në veprimtari të ndryshme për edukimin mjedisor në shkollë?				
9	Si mendoni, a i respekton shkolla rregullat për mjedisin e komunitetit tuaj?				
10	Komuniteti i shkollës, a kontribuon që të përmbushë standardet e duhura për mjedisin ku jeton?				

4. Pyetësor për mësuesin.

Nr	Lexoni kërkesat e mëposhtme	Plotësoni.
1	A planifikoni në mësimdhënien tuaj veprimtari për edukimin mjedisor?	Qarkoni PO JO. Nëse po, shkruani 2-3 tituj të veprimtarive. _____ _____
2	A i kryejnë fëmijët e klasës suaj kujdestare detyrat dhe përgjegjësitë e duhura për mjedisin në shkollë dhje komunitet?	Qarkoni PO JO. Nëse po, shënoni X anash alternativave. Asnjëherë ____ Rrallëherë ____ Shpeshherë ____ Gjithmonë ____
3	A realizoni veprimtari jashtëshkollë që lidhen me edukimin mjedisor?	Qarkoni PO JO. Nëse po, shkruani titujt e 3 veprimtarive të realizuara. 1 _____ 2 _____ 3 _____
4	A marrin pjesë prindërit në veprimtaritë që ju zhvillojnë në shkollë për edukimin mjedisor?	Qarkoni PO JO. Nëse po, shënoni X anash alternativave. Asnjëherë ____ Rrallëherë ____ Shpeshherë ____ Gjithmonë ____
5	Si i përfshini tematikat për mjedisin në procesin mësimor?	Qarkoni PO JO. Nëse po, shënoni me x një nga alternativat e integritit që ju përdorni më shpesh: -I lidhni në një temë mësimi ____ -Bëni veprimtari të gatshme ____ -I realizoni në varësi të metodave që përdorni në mësim. ____
6	Mjedisi në shkollë ndikon në krijimin e një klime besimi dhe sigurie.	Qarkoni PO JO. Nëse po, pse? Jepni 2-3 mendime shkurt: _____ _____
7	A ka gazetë shkollë juaj ose klasë/kabinet të veçantë për edukimin mjedisor?	Qarkoni PO JO. Nëse po, a trajtohen të drejtat dhe përgjegjësitë në të? Shkruani 2-3 tituj shkrimesh. 1 _____ 2 _____ 3 _____
8	Nëse ju realizoni veprimtari të edukimit mjedisor, cilët tregues shfaqen më dukshëm në mjedisin e shkollës, të shtëpisë dhe komunitetit?	Shënoni X, nëse treguesit e mëposhtëm shfaqen në shkollë: - Realizohen pothuajse të gjitha rregullat për mjedisin nga fëmijët ____ - Fëmijët shprehin hapur mendimet e tyre për probleme mjedisore ____ - Mjedisi i shkollës është gjithmonë i pastër ____ - Fëmijët e konsiderojnë shkollën si një familje ku prindër, mësues, nxënës punojnë së bashku ____ - Fëmijët janë të ndjeshëm ndaj respektimit dhe mbrojtjes së mjedisit. _____ - Fëmijët kanë dëshirë të vijnë gjithmonë në shkollë të merren me kujdesin ndaj mjedisit të saj ____ - Në klasat ku realizohet edukimi mjedisor ka tregues të lartë për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit jetësor ____ - Fëmijët marrin vetë vendime për shumë çështje mjedisore të klasës dhe shkollës ____ - Fëmijët ndihmojnë në problemet e ndryshme mjedisore të komunitetit ____

SHTOJCA 2

Instrumentet e vlerësimit të projektit te përdorur nga projekti Cleen

Vlerësimi i projektit është një nga pikat kyçe të suksesit të projektit. Ky vlerësim është i menduar në disa nivele sipas komponentëve të projektit, vlerësim i trajnimit të mësuesve, vlerësim i njohurive të marra në trajnim, vlerësim i vetë mësuesit dhe drejtorit të shkollës mbi ecurinë e projektit, vlerësim i planit COMBI (Komunikimi për Impaktin tek Sjelljet), si dhe vlerësim i jashtëm i projektit që do të përmbajë të gjitha këto komponente.

Për sa i përket vlerësimit në shkollë, gjë për të cilën kjo guidë është e interesuar, instrumentet e vlerësimit janë si më poshtë:

A - Plani vjetor (Tabela 1)

Plani vjetor është një mjet i menduar për t'u përfshirë në planin vjetor të shkollës ku mësuesi shënon në mënyrë të rregullt sipas secilës nënçështje numrin e sesioneve të zhvilluara në klasë, cilat metoda të të mësuarit aktiv që do të përdoren, aktivitete në nivel shkollë, aktivitete me prindërit/në shtëpi si dhe me komunitetin.

Tabela 1. Plani Vjetor

Moduli	Nënçështja	Nr. i sesioneve në klasë (cilat aktivitete të mësuarit aktiv do të përdoren)	Aktivitete në nivel shkolle	Aktivitete me prindërit/në shtëpi	Aktivitete me komunitetin
Ajri:	Nënçështja 1				
	Nënçështja 2				
	Nënçështja 3				
				
Uji	Nënçështja 1				
	Nënçështja 2				
	Nënçështja 3				
				
Ndotja	Nënçështja 1				
	Nënçështja 2				
	Nënçështja 3				
				
Toka	Nënçështja 1				
	Nënçështja 2				
	Nënçështja 3				
				
Ndotja	Nënçështja 1				
	Nënçështja 2				
	Nënçështja 3				
				

Nr. i çështjeve për klasë = 3

Numri i përgjithshëm i orëve mësimore mbi EM për klasë = 24 deri në 30

B – Planifikimi mësimor nga ana e mësuesit (Tabela 2)

Planifikimi mësimor i mësuesit (njihet gjithashtu me emrin formati mësimor) është një plan mbi një çështje në modul dhe paraqitet si një shtesë në Planin vjetor. Tabela duhet të përsëritet për secilën çështje. Mësuesit e çdo klase priten të plotësojnë 3 çështje. Sugjerohet që Planifikimi i mësuesit dhe lista e plotë që e shoqëron, të mbahen në Librin e Shënimeve të Mësuesit. Libri i Shënimeve mund të shqyrtohet nga drejtori dhe nga grupi vlerësues herë pas herë.

Tabela 2. Ditari i mësuesit per temat mjedisore

Moduli:	Klasa:	Data nga:	Data deri në:	
Emri i mësuesit				
Nënçështja				
Dita	Aktivitete në klasë	Metoda e të Mësuarit Aktiv	Burime të nevojshme	Shënime në fund të ditës
Dita një				
Dita dy				
Dita tre				
Dita katër				
Dita pesë				
Dita gjashtë				
Aktivitete jashtë klase – shkollë				
Aktivitete jashtë klase – shtëpi				
Aktivitete jashtë klase – komunitet				
Ndonjë koment tjetër:				

C -Vetëvlerësimi për mësuesit: Lista e Ndjekjes së Hapave (Tabela 3)

Kjo listë e ndjekjes së hapave plotëson Planifikimin e Mësuesit. Për çdo çështje, mësuesi mund të bëjë një vetëvlerësim nëse procesi është përmbushur. Në Librin e Shënimeve të Mësuesit, duhet të paraqiten tre tabela shënimesh, të cilat ndiqen nga një listë e plotë e veprimeve. Mund të mbahen dhe disa faqe shtesë në fund të planifikimit, për ndonjë koment shtesë ose reflektime nga ana e mësuesit. Në fund duhet të lihet vend bosh për firmën e drejtorit.

Tabela 3. Vetëvlerësimi për Mësuesit

D – Raporti i mbledhjes - COMBI (Tabela 4)

Kjo tabelë do të mbushet vetëm nga shkollat të cilat marrin pjesë në këtë program për mbledhjen e mbeturinave. Në këto shkolla në bazë mujore do të plotësohet sasia e mbeturinave të mbledhura nga fëmijët.

A i ndoqëm unë dhe klasa këto hapa dhe ndonjë nga aktivitetet e sugjeruara?	Data – Fillimi dhe Përfundimi	Hapi Një Të Kuptuarit A e kam prezantuar temën duke përdorur historin, piktura, luajtje rolesh, lojëra?	Hapi Dy Zbulim i Fakteve A kanë bërë fëmijët një anketë; kanë punuar me fletoret e punës, kanë lexuar diçka më shumë?	Hapi Tre Diskutimi dhe Planifikimi/ Ndërmarrja e Veprimeve A kanë bërë fëmijët një plan, kanë përgatitur materiale / për veprime të mëvonshme, kanë zhvilluar diskutime në grupe, kanë krijuar një bazë? / Fëmijët kanë ndërmarrë veprime në shkollë, familje dhe/ose në komunitet?	Hapi Katërt Vlerësimi/ Bërija më Mirë Fëmijët kanë analizuar përfundimet nga diskutimet, diagramet, kanë plotësuar fletoret e punës. A i kam korrigjuar fletoret e punës? / Fëmijët dhe unë kemi diskutuar se çfarë do të bëjmë më tej	A i kam përdorur udhëzimet?	A kam biseduar me prindërit në shoqatën e prindërve ose takime të tjera mbi çështjen?	A kam planifikuar veprimtari me komunitetin?
Nënçështja1								
Nënçështja2								
Nënçështja3								

Ndonjë vëzhgim apo koment:

E parë nga Drejtori: Firma _____, Data _____

E parë nga Vrojtesit: Firma _____, Data _____

Tabela 4. Raporti i mbledhjes - COMBI

Emri i shkollës:

Viti:

Mbledhja sipas muajve (në kile)

Klasa	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
I											
II											
III											
IV											
V											
Totali											

Komente: _____

SHTOJCA 3

Hapat për realizimin në shkollë të një projekti mjedisor

- i. Njohja dhe studimi i gjendjes
 - Cilat janë shqetësime të shkollës dhe komunitetit në lidhje me mjedisin në të cilat, nxënësit mund të kontribuojnë për reduktimin apo zgjidhjen e problemit?
 - Si dhe në ç'mënyrë mund të kontribuojë çdo fushë kurrikulare, çdo klasë, çdo mësues për zgjidhjen e problemeve të evidentuara?
 - Në ç'nivel është përgatitja teorike dhe praktike e nxënësve në lidhje me kërkesat që përcjell procesi i zgjidhjes së problemit të dhënë mjedisor ?
 - Çfarë të ardhurash financiare dhe mundësish të bashkëpunimit me aktorë të tjerë në komunitet mund të sigurojë shkolla në lidhje me realizimin e projektit mjedisor ?

- ii. Hartimi i planit të punës

Në këtë hap, kërkohet që më parë të përcaktohet politika shkollore e edukimit mjedisor për vitin. Përcaktimi i politikës së veprimtarive mjedisore në shkollë bëhet përmes konsultave mes mësuesve, nxënësve e specialistëve të mjedisit të cilët së bashku do të vendosin për qëllimet dhe nevojat e edukimit mjedisor për shkollën gjatë vitit të dhënë shkollor.

Mbi bazën e njohjes së gjendjes dhe përcaktimit të politikës shkollore të edukimit mjedisor bëhet planifikimi, përcaktohen veprimtaritë, koha e realizimit të tyre dhe personat përgjegjës

për secilën nga veprimtaritë e planifikuara.

- iii. Kryerja e veprimtarive (zbatimi)

Kryerja e veprimtarive është element shumë i rëndësishëm në një projekt shkollor për mjedisin. Që ky hap të përcillet me sukses ekipi drejtues i projektit duhet:

 - të sqarojë personelin për rolin dhe përgjegjësitë në projektin e dhënë;
 - të organizojë trajnimet e nevojshme për të përmbushur nevojat e ngritjes së kapaciteteve të personelit;
 - të sigurojë burimet e nevojshme fizike e financiare për zbatimin e tij;
 - të mundësojë tërheqjen e sektorit privat, specialistëve të mjedisit, të pushtetit vendor në angazhime konkrete në projektin mjedisor të shkollës.

- iv. Vlerësimi

Si një element mjaft i rëndësishëm në kryerjen e veprimtarive shkollore për mjedisin, ku do të merren përgjigje për pyetjen të tilla si:

 - Cilat janë përfitimet e nxënësve nga aktivitetet mjedisore të zhvilluara?
 - Si janë thithur burimet nga shkolla?
 - Në ç'pjesë programi shkollor është zbatuar me sukses e ku jo?
 - Ç'duhet bërë më tej?

Si përfundim mund të themi se, nevojat e edukimit mjedisor të nxënësve plotësohen si brenda orëve të mësimit ashtu dhe jashtë tyre në natyrë e komunitet por, në të dyja rastet është i nevojshëm konceptimi dhe planifikimi paraprak i asaj që do të bëhet me nxënësit.